

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6790
E shtunë, 24 dhjetor 2022
çmimi 0.40

Rektori takon profesorët me numrin më të madh të citimeve në platforma ndërkombëtare | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

BE-ja E PAKËNAQUR ME MIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR ZYRTARËT PUBLIKË DHE PËR PAGA

FAQE 4-5



Bashkimi Evropian (BE) ka reaguar ndaj miratimit të Projektligjit për Zyrtarët Publikë dhe atij për Paga në sektorin publik në Kuvendin e Kosovës të enjten. Gjatë hartimit të këtyre

projektligjeve, BE-ja kishte paraqitur disa komente, të cilat, sipas saj, nuk u morën parasysh në votimet në Kuvend. Edhe Instituti Kosovar për Drejtësi (IKD) ka bërë me dije se komentet

e tyre dërguar për të dyja projektligjet nuk janë marrë për bazë. Njëjtë kanë dërguar komente edhe shumë OJQ dhe institucione të pavarura, por nuk janë marrë parasysh nga pushteti

AKTUALE



TRE TË VDEKUR NGA TË SHTËNAT NË QENDËR TË PARISIT | F. 2

A ËSHTË E MUNDSHME ZGJIDHJA PAQËSORE, APO DUHET KONFRONTIM ME DHUNË NË VERIUN E KOSOVËS? | F. 6

KURTI: PËRMES ZHVILLIMIT TË QEVERISJES ELEKTRONIKE PO SYNOJMË RITJEN E TRANSPARENCËS E LLOGARIDHËNIES | F. 5

EKONOMI



BANKAT NË EVROPËN QENDRORE, LINDORE DHE JUGLINDORE PRESIN RITJE TË KËRKESËS PËR KREDI | F. 8

DY MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE SHKOJNË PËR VOTIM NË KUVEND | F. 8

SPORT



KUKA: LAURA NUK E VIZITON ME MUJ FAMILJEN VETËM QË TË MOS HUMBË ASNJË STËRVITJE | F.12



BE-JA NDIHMOM NË PËRMIRËSIMIN E SIGURISË LIGJORE NË KOSOVË, DOKUMENTET PENALE BËHEN ÇËSHTJE E SHOYRTIMIT PUBLIK | FAQE 3



SITUATA NË VERI: OPOZITA AKUZON QEVERINË SE RA NË KURTHIN E SERBISË | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kompania kineze pranon se përdori të dhënat e "TikTok"-ut për t'i gjurmuar gazetarët

PENIK, 23 DHJETOR - Punonjësit e kompanisë kineze të teknologjisë, "ByteDance", siguruan qasje në të dhënat nga platforma e medieve sociale, "TikTok", për t'i gjurmuar gazetarët në një përpjekje për ta identifikuar burimin e rrjedhjeve të informacioneve në medie, tha kompania të premten.

"TikTok"-u ka bërë përpjekje të mëdha për t'i bindur klientët dhe qeveritë e tregjeve kryesore si - Shtetet e Bashkuara - se privatësia e të dhënave të përdoruesve mbrohet dhe se nuk përbën kërcënim për sigurinë kombëtare. Por, kompania amë, "ByteDance", i tha AFP-së të premten se disa punonjës patën qasje në të dhënat e dy gazetarëve si pjesë e një hetimi të brendshëm për rrjedhjet e informacionit të kompanisë në medie. Ata kishin shpresuar të identifikonin lidhjet midis stafit dhe një gazetari të "Financial Times" dhe një ish-gazetari të "BuzzFeed", u tha në një email nga këshilltari i

përgjithshëm i "ByteDance", Erik Andersen, i parë nga AFP-ja. Të dy gazetarët raportuan më parë për përmbajtjen e materialeve që kanë rrjedhë nga kompania.

Secili prej punonjësve që u zbulua se ishte përfshirë u pushua nga puna nga "ByteDance", tha Andersen, megjithëse ai nuk bëri me dije sa ishte numri i tyre.

Në një deklaratë për AFP-në, "ByteDance" tha se e dënon "iniciativën e gabuar që shkeli rëndë Kodin e sjelljes të kompanisë".

Punonjësit kishin marrë adresat IP të gazetarëve në një përpjekje për të përcaktuar nëse ata ishin në të njëjtin vend me kolegët e "ByteDance" të dyshuar për zbulimin e informacionit konfidencial. Megjithatë, plani dështoi pjesërisht sepse adresat IP zbuluan vetëm të dhëna të përafërta të vendndodhjes.

TikTok është sërish në qendër të vëmendjes në Shtetet e



Bashkuara, ku Kongresi është gati të miratojë një ndalim mbarëkombëtar për përdorimin e aplikacionit jashtëzakonisht të popullarizuar të videove të shkurtra në pajisjet qeveritare për shkak të rreziqeve të perceptuara të sigurisë.

Dhoma e Përfaqësuesve mund të

miratojë këtë javë një ligj që ndalon përdorimin e TikTok-ut në telefonat profesionistë të nëpunësve civilë, një veprim që do të pasonte ndalimet në rreth 20 shtete të ShBA-së.

TikTok-u ka kërkuar t'i bindë autoritetet amerikane se të dhënat e ShBA-së mbrohen dhe

ruhen në serverët e vendosur atje. Por, pas raportimeve të medieve, ajo ka pranuar se punonjësit me bazë në Kinë kishin qasje në të dhënat e përdoruesve amerikanë, megjithëse kompania këmbënguli se ishte në rrethana strikte dhe shumë të kufizuara.

Seuli: Koreja e Veriut lëshoi dy raketa balistike



PHENIAN, 23 DHJETOR - Koreja e Veriut lëshoi dy raketa balistike me rreze të shkurtër të premten, tha ushtria e Seulit.

Koreja e Veriut ka bërë disa teste me raketa këtë vit duke përfshirë lëshimin e raketës balistike ndërkontinentale më të avancuar muajin e kaluar. "Ushtria jonë vërejtë dy raketa balistike me rreze të shkurtër veprimi të lëshuar nga Koreja e Veriut në Detin Lindor nga zona Sunan e Phenianit", tha shefi i përbashkët i shtabit të Koresë së Jugut, duke iu referuar asaj që njihet si Deti i Japonisë. "Ushtria jonë mban një pozicion gatishmërie të plotë, ndërsa bashkëpunon ngushtë me ShBA-në duke forcuar mbikëqyrjen dhe vigjilencën", tha tutje ai.

Shtetet e Bashkuara dhe Koreja e Jugut kanë paralajmëruar prej muajsh se Pheniani po përgatitet ta kryejë testin e shtatë bërthamor. Të dy vendet mbajtën një stërvitje të përbashkët ajrore të martën dhe vendosën një bombardues strategjik amerikan B-52H në gadishullin korean, sipas shefave të shtabit të përbashkët të Koresë së Jugut.

Bombarduesi i rëndë me rreze të gjatë ishte pjesë e një stërvitjeje që përfshinte avionët më të avancuar të ShBA-së dhe Koresë së Jugut duke përfshirë F-22 dhe F-35. Lansimi i raketës të premten ndodhi disa orë pasi Shtëpia e Bardhë tha se Pheniani i kishte dorëzuar armë grupit ushtarak privat rus, Wagner.

Tre të vdekur nga të shtënat në qendër të Parisit

PARIS, 23 DHJETOR - Tre persona u vranë dhe disa të tjerë u plagosën nga të shtënat në qendër të Parisit të premten, sipas autoriteteve franceze.

Numrin e të vdekurve e ka konfirmuar Laure Beccuau, prokurore në Paris. "Janë tre të vdekur, një person në kujdes intensiv dhe dy persona me lëndime serioze. Po ashtu, i dyshuari që është arrestuar, është i lënduar kryesisht në fytyrë", u tha prokurorja gazetareve në vendngjarje. Siç raporton BBC-ja, i dyshuari

është një 69-vjeçar. Personi i arrestuar, sipas televizionit francez BFM TV, ishte i njohur për autoritetet franceze pasi kishte sulmuar një kamp emigrantësh një vit më parë. Motivet e personit të armatosur mbeten të paqarta.

Incidenti i të shtënave të së premtes në Paris ndodhi në një qendër lokale kurde, u tha gazetareve kryebashkiaku i qarkut të 10-të të qytetit. Policia e Parisit në "Twitter" tha se një operacion lidhur me këtë rast është duke vazhduar dhe u

ka kërkuar qytetarëve që ta shmangin frekuentimin në këtë zonë. "Është panik total, ne jemi mbyllur brenda", tha një pronare e një dyqani për agjencinë e lajmeve AFP.

Dëshmitarja tha se kishte dëgjuar shtatë ose tetë breshëri të shtënash.

Sipas agjencisë së lajmeve "Associated Press", prokurorët e Antiterrorizmit janë në kontakt me hetuesit, por nuk kanë dhënë indikacione se ka ndonjë shenjë të një motivi terrorist në këtë fazë.



Situata në veri: Opozita akuzon qeverinë se ra në kurthin e Serbisë

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Deputetët e partive opozitare të premtën në seancën e Kuvendit Kosovës kanë kritikuar qeverinë për menaxhimin e situatës në veri të vendit.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Anton Quni, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për situatën e tensionuar në pjesën veriore të Kosovës, ku rrugët janë të bllokuara tash e dy javë.

Deputeti Quni ka thënë se situata në katër komunat e veriut, të banuara me shumicë serbe, është jashtë kontrollit "për shkak të veprimeve të papërgjegjshme të Qeverisë së Kosovës". "Sot veç një detyrë e ka kjo qeveri, të mos vazhdojë të bjerë më në kurthet e kundërshtarit [Serbisë]", ka

deklaruar Quni.

Ai ka thënë se veprimet e qeverisë kanë rrezikuar edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Më 8 dhjetor, para vendosjes së barrikadave në veri, ishte plagosur një zyrtar i Policisë së Kosovës.

Duke iu referuar situatës në veri, deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Bekë Berisha, ka thënë se veprimet e qytetareve serbë në veri, të sponsorizuara nga Serbia, "nuk e trembin dhe nuk kanë kurrfarë efekti për Kosovën".

Ai i bëri thirrje kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që të dalë nga "kurthi" që, sipas tij, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ia ka përgatitur.

Ndërkohë deputeti i Lëvizjes



Vetëvendosje, Luan Aliu, ka thënë se përmes tensionimit të situatës në veri "Serbia po kërkon ta vazhdojë luftën të cilën e humbi

dekada më parë".

Aliu ka thënë se situata e tanishme nuk do të tolerohet pafundësisht.

Më 10 dhjetor grupe të serbëve në veri ngritën barrikada në rrugët kryesore që çojnë në pikat kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak.

Qeveria e Kosovës i ka kërkuar KFOR-it që t'i largojë barrikadat ndërkohë që ka thënë se ekzistojnë kapacitetet që këtë gjë ta bëjnë edhe vetë.

Më 22 dhjetor mijëra qytetarë serbë morën pjesë në një protestë në fshatin Rudar të Zveçanit.

Ata i vendosën disa kushte për largimin e barrikadave, përfshirë lirin e ish-politit të Kosovës, Dejan Pantiq, i cili u arrestua si i dyshuar për organizim të sulmeve terroriste në zyrat e Komisionit Qendror Zgjedhor në Mitrovicë të Veriut dhe Zubin Potok.

BE-ja ndihmon në përmirësimin e sigurisë ligjore në Kosovë, dokumentet penale bëhen çështje e shqyrtimit publik

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 23 dhjetor - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i mbështetur nga Bashkimi Evropian në Kosovë, ka lansuar sistemin e parë online të të dhënave të centralizuara kriminale (DKCK) i cili do t'i mundësojë publikut dhe institucioneve që shpejt dhe pa prituri në radhë të kenë qasje dhe të marrin certifikatat e dosjeve kriminale.

Certifikatat e dosjeve kriminale

ofrojnë informacion të rëndësishëm në shumë procese vendimmarrjeje dhe nevojiten për të përfunduar shumë procedura administrative si aplikimi për një vend pune, aplikimi për vizë etj. Sistemi i ri do ta bëjë këtë shumë më të lehtë, duke kontribuar më tej në sigurinë juridike dhe transparencën.

Mbështetja e BE-së me vlerë 3.6 milionë euro për zhvillimin e DKCK-së, i cili funksionon sipas kërkesave të Sistemit të Informacionit të të Dhënave

Penale Evropiane (SEIDP), përfshinte sigurimin e të gjithë harduerit të nevojshëm dhe zhvillimin e softuerit dhe kornizës ligjore dhe administrative. "Sundimi i ligjit mbetet një nga prioritetet më të rëndësishme në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Duke pasur një sistem që siguron transparencë të plotë ligjore dhe qasje në dosjet kriminale, do ta bëjë vendimmarrjen në sfera të ndryshme të jetës shumë më të lehtë, duke përfshirë kontraktimet e brendshme dhe investimet e

huaja, duke kontribuar kështu edhe në zhvillimin ekonomik", ka thënë kreu i BE-së në Seksionin për Bashkëpunim të Kosovës, Johannes Madsen.

Pas kërkesave për mbrojtjen e të dhënave, Prokuroria, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues dhe Ministria e Punëve të Brendshme do ta përdorin DKCK-në për të shkëmbyer informacione dhe për të mbajtur të dhënat e përditësuara. "Sistemi DKCK shënon një moment historik të rëndësishëm në përpjekjet për ta

rritur transparencën dhe për ta përmirësuar perceptimin publik për gjyqësorin, gjithashtu do ta sjellë Kosovën një hap më afër rrugës së saj drejt anëtarësimit në BE", ka theksuar kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj. BE-ja në Kosovë mbështet fuqishëm përmirësimin e sundimit të ligjit dhe funksionimin e sistemit gjyqësor të Kosovës, me projekte të asistencës teknike, për ta ndihmuar Kosovën të përparojë në rrugën e saj drejt integritimit evropian.



BE-ja e pakënaqur me miratimin e Projektligjit për Zyrтарët Publikë dhe për Paga

Bashkimi Evropian (BE) ka reaguar ndaj miratimit të Projektligjit për Zyrтарët Publikë dhe atij për Paga në sektorin publik në Kuvendin e Kosovës të enjten. Gjatë hartimit të këtyre projektligjeve, BE-ja kishte paraqitur disa komente, të cilat, sipas saj, nuk u morën parasysh në votimet në Kuvend. Edhe Instituti Kosovar për Drejtësi (IKD) ka bërë me dije se komentet e tyre dërguar për të dyja projektligjet nuk janë marrë për bazë. Njëjtë kanë dërguar komente edhe shumë OJQ dhe institucione të pavarura, por nuk janë marrë për bazë nga ana e pushtetit

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHINË, 23 DHJETOR - Bashkimi Evropian ka reaguar ndaj miratimit të Projektligjit për Zyrтарët Publikë dhe atij për Paga në sektorin publik në Kuvendin e Kosovës të enjten. Sipas njoftimit nga Bashkimi Evropian, gjatë hartimit të këtyre projektligjeve BE-ja kishte paraqitur disa komente, të cilat, sipas saj, nuk u morën parasysh në votimet në Kuvend. "Komentet kishin për qëllim të udhëzojnë në mënyrën më të mirë dhe ta mbështesin qeverinë për të siguruar një shërbim civil të depolitizuar dhe profesional, me një sistem transparent të shpërblyerit të

bazuar në merita, në përputhje me parimet e reformës së administratës publike dhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës", thuhet në reagimin e BE-së.

Sipas BE-së, projektligji i ri për zyrтарët publikë është problematik, "pasi shton liri të tepruar veprimi në procedurat e rekrutimit, transferimit, si dhe në procedurat disiplinore të nëpunësve civilë, duke e bërë shërbimin civil potencialisht të cenueshëm ndaj politizimit". Edhe Instituti Kosovar për Drejtësi (IKD) ka bërë me dije se komentet e tyre dërguar për të dyja projektligjet nuk janë marrë për bazë.

Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv në IKD, ka theksuar se instituti që drejton ka dërguar komente si për Ligjin për Paga ashtu edhe për Ligjin për Zyrтарët Publikë. "Komentet, sugjerimet, rekomandimet pothuajse janë injoruar krejtësisht. Njëjtë kanë dërguar komente edhe shumë OJQ të tjera dhe institucione të pavarura. Janë injoruar njëjtë. Si përfundim, dy ligjet në pjesë të caktuara cenojnë sigurinë juridike dhe financiare të institucioneve të pavarura dhe, çka është shumë shqetësuese, administratën publike e kthejnë nga një shërbim civil, në shërbim politik", ka thënë Miftaraj. Ai ka theksuar se partitë opozitare, institucionet e

pavarura e kanë obligim t'i dërgojnë këto dy ligje në Gjykatën Kushtetuese. "Politikbërja dhe vendimmarrja duhet të bazohen në standardet minimale të pjesëmarrjes së publikut në konsultime publike të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Pjesëmarrja nuk konsiderohet se zbatohet në praktikë vetëm përmes dërgimit të komenteve dhe injorimit të tyre nga institucionet publike, pa përgjigje dhe arsyetim me shkrim pse nuk janë marrë për bazë komentet. Praktikë e keqe që duhet të ndalet", ka deklaruar Miftaraj. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, pa mbështetjen e partive opozitare, votuan në lexim të dytë Projektligjin për Paga. Kuvendi i Kosovës në seancën e 22 dhjetorit ka miratuar në lexim të dytë edhe Projektligjin për Zyrтарët Publikë. Në të dyja votimet e projektligjeve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka abstenuar. Ndërkaq partitë opozitare nuk e kanë mbështetur Projektligjin për Paga

dhe as Projektligjin për Zyrтарët Publikë.

Përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se këto dy projektligje t'i dërgojnë në Kushtetuese. Deputeti Bekim Haxhiu nga subjekti opozitar Partia Demokratike e Kosovës tha se do ta kërkojë mendimin e Gjykatës Kushtetuese për Projektligjin për Paga.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se ky projektligj është mashtrimi i radhës i qeverisë Kurti. "E tash që kaloi Ligi i Pagave, a ka dikush në qeveri që mund të na tregojë sa është rroga e një zyrtari të shtetit? Terr informativ, manipulim dhe, siç po duket, edhe një mashtrim i radhës", ka thënë Tahiri.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka reaguar pas miratimit në Kuvend të Ligjit për Zyrтарët Publikë, i cili parasheh ndërprerjen e kontratave të punës për rreth 1 600 zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues dhe ripërcaktimin e këtyre pozitave

Kurti: Përmes zhvillimit të qeverisjes elektronike po synojmë rritjen e transparencës e llogaridhënies

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Digjitalizimi i gjithëmbarshtëm është një nga objektivat kyçe të programit qeverisës dhe është pjesë e të gjitha shtyllave të Planit Kombëtar për Zhvillim 2030. Kështu ka thënë kryeministri Albin Kurti në takimin e parë të Komisionit për Transformim Digjital.

Ai ka theksuar se përmes zhvillimit të qeverisjes elektronike po synojmë rritjen e transparencës e llogaridhënies dhe përmirësimin e shërbimeve tona ndaj qytetarëve dhe bizneseve. "Me digjitalizimin, që është i ndërlidhur ngushtë me reformën dhe modernizimin e administratës publike, do të krijohen shërbime elektronike, që në qendër e kanë qytetarin", shtoi ai.

Duke pasur parasysh rëndësinë e transformimit digjital në të gjitha fushat e qeverisjes dhe nevojën për avancim të mekanizmave qeverisës për realizimin e këtij transformimi, është themeluar Komisioni për Transformim Digjital, që do ta mbikëqyrë dhe sigurojë mbarëvajtjen e procesit

të transformimit digjital. Komisioni do t'i shqyrtojë dhe miratojë prioritetet strategjike dhe iniciativat e politikave të reja të qeverisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit, ofrojë drejtim strategjik si dhe do të sigurojë koordinim ndërinstucional në projektet me rëndësi të lartë në këtë fushë.

Në takim u theksua se gjatë këtij viti që po e lëmë pas Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë disa hapa të rëndësishëm në fushën e digjitalizimit: Janë lansuar një sërë shërbimesh elektronike për qytetarë dhe biznese, duke u përqendruar në shërbimet më të përdorura, që kanë shkaktuar më së shumti radhë nëpër sportele. Është lansuar sistemi elektronik për hartimin e legjislacionit dhe kemi filluar pilotimin e projektit të rëndësishëm të ndërlidhjes së qytetarit me adresë. Qeveria ka aprovuar strategjinë e re të arsimit, ku digjitalizimi në arsim është një nga 5 shtyllat e saj. Është miratuar në qeveri projektligji për sigurinë

kibernetike dhe është lansuar sistemi për monitorimin e spektrit frekuencor. Është promovuar lansimi i qendrës së të dhënave për Rrjetin Akademik dhe Hulumtues të Kosovës.

Vendi ynë për herë të parë u bë nikoqir i Samitit Digjital Regional.

Qeveria është në finalizim të dokumenteve kyçe strategjike të strategjisë së e-qeverisjes, strategjisë së sigurisë kibernetike dhe agjendës digjitale.

Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e zbatimit të projekteve strategjike me partnerët zhvillimorë si USAID, GIZ dhe Banka Botërore.

Së fundmi, përparimi ynë në fushën e digjitalizimit është njohur edhe nga Indeksi i Bankës Botërore të maturitetit të teknologjisë në qeveri (GTMI). Kosova këtë vit është kategorizuar në grupin B të vendeve me fokus të konsiderueshëm në qeverisje digjitale, që shënon përparim nga viti 2020, kur ka qenë e kategorizuar në Grupin C të vendeve me fokus të kufizuar në qeverisje digjitale.

Mavraj mbështet protestën kundër padrejtësisë së Gjykatës Speciale



PRISHTINË, 23 DHJETOR - Publicisti Muhamet Mavraj i ka dhënë mbështetje protestës së paralajmëruar për të shtunën në Prishtinë kundër padrejtësisë së Gjykatës Speciale.

Mavraj ka shkruar në "Facebook" se Kosova dha besim për drejtësinë dhe nuk dha besim për abuzim "në emër të popullit".

"Jo në emrin tim! E mbështes plotësisht këtë protestë që mbahet në orën 14:00 në Prishtinë. Kosova dha besim për drejtësinë dhe nuk dha besim për abuzim "në emër të popullit". Jo në emrin tim! Na janë shtuar padrejtësitë e poshtërimet nga brenda e nga jashtë. Nuk kemi vdekur! Këtu dha besim për abuzim "në emër



me mandat katërvjeçar. Kreu i PDK-së është shprehur se misioni i ri i qeverisë Kurti është largimi masiv nga puna i zyrtarëve publikë, shantazhimi, politizimi dhe nënshtrimi i tyre. "Keqqeverisja, punësimet partiake, skandalet në shëndetësi, dështimet në ekonomi dhe energji, ikja e të rinjve nga vendi, rrezikimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të shtetit në vetëm dy vjet qeverisje, nuk po i mjaftojnë kryeministrit Kurti dhe

qeverisë së tij. Tani, përmes Ligjit për Zyrarët Publikë, misioni i ri i kësaj qeverie është largimi masiv nga puna i zyrtarëve publikë, shantazhimi, politizimi dhe nënshtrimi i tyre. E gjithë kjo, duke shkelur të drejtat e njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës", ka deklaruar Krasniqi. Ai ka theksuar se Ligji për Zyrarët Publikë bie ndesh edhe me detyrimet që Kosova ka marrë. "Gjithsesi, përballë këtyre tendencave kundërkushtetuese,

Partia Demokratike e Kosovës nuk do të qëndrojë duarkryq. Ne do ta kundërshtojmë dhe do ta dërgojmë atë në Gjykatën Kushtetuese, ku, duke besuar në drejtësi, presim rrëzimin e padiskutueshëm të tij", është shprehur Krasniqi. Ndërsa deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, ka thënë se ky Projektligj shpreh indinjatën e 80 mijë zyrtarëve të administratës. "LDK-ja shpreh indinjatën për mbi 80 mijë

zyrtarët e administratës publike. Po dëshironi t'i jepni legalitet për ta shkatërruar këtë administratë. Me këtë Ligj po cenohet administrata. Kjo është mundësi për politizimin e kësaj administrate. Për herë të parë keni vendosur kriteret si në sistemin komunist. Me këtë Ligj po i ktheni kontratat mbi vepër", ka thënë Selmanaj.

Ligji i Pagave ishte miratuar një herë në shkurt të vitit 2019, por një muaj para se të niste zbatimi

i tij - në janar të 2020-s - institucioni i Avokatit të Popullit e pati dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese për, siç kishte thënë, "vlerësimin e përputhshmërisë" së tij me Kushtetutën e Kosovës. Gjykata, më pas, konstatoi se ligji i miratuar nuk ishte në përputhje me 11 nene të Kushtetutës dhe se shkaktonte "çrregullim të ndarjes së pushteteve në disfavor të gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura".

Rektori takon profesorët me numrin më të madh të citimeve në platforma ndërkombëtare

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Qerim Qerimi, ka ftuar të premten në takim profesorët e UP-së me më së shumti citime në platforma ndërkombëtare. Shkencëtarët më aktivë të Universitetit të Prishtinës ai i takoi në ambientet e Rektoratit, i shoqëruar nga prorektori për kërkime, projekte, inovacion dhe informacion, prof. dr. Sefer Avdiaj, dhe zyrtari për mbështetjen e kërkimeve shkencore, Fitim Seferi. Qerimi shprehu mirënjohjen personale të tij dhe të Universitetit të Prishtinës për

kontributin e dhënë për UP-në për vite e dekada, duke ndihmuar kështu në ngritjen e nivelit të hulumtimeve shkencore, në imazhin e institucionit dhe në rangimin më të mirë ndërkombëtar të institucionit tonë. “Në mënyrë që ju dhe institucioni të mund të përfitojnë nga dobia e punës suaj, kam paraparë ndryshime në Statut, të cilat afektojnë edhe aspektin e hulumtimit shkencor. Ndër të tjera, është parë si e nevojshme që për profesorët që shquhen për numrin e madh të citimeve apo impakti në avancimin shkencor të UP-së, të

krijohen një sërë lehtësirash, duke iu ofruar përparësi për avancim në thirrje më të lartë akademike, më tepër kohë në dispozicion për hulumtim, përparësi në qasje në fonde kërkimore të universitetit apo institucioneve të tjera”, informoi rektori Qerimi. Në anën tjetër, profesorët e pranishëm në këtë takim u shprehën të nderuar me vlerësimin që u është bërë nga rektori i UP-së, teksa theksuan gatishmërinë e tyre për ta ndihmuar edhe më tepër në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në UP.



Në takim u diskutua rreth projekteve konkrete të cilat influencojnë kërkimin shkencor, por edhe për rritjen e buxhetit të ndarë për shkencë nga ana e UP-së.

A është e mundshme zgjidhja paqësore, apo duhet konfrontim me dhunë në veriun e Kosovës?

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Lëvizja për Bashkim (LB) ka reaguar në lidhje me situatën në veri. Sipas kësaj partie, subjektet politike, e sidomos qeveria, duhet t'i vlerësojnë me gjakftohtësi konfliktet politike, me theks të veçantë ato ndërkombëtare, sidomos kur janë pjesë e atyre konflikteve. “A është e mundshme zgjidhja paqësore, apo duhet konfrontim me dhunë në veriun e Kosovës?”, ka pyetur LB-ja, e cila drejtohet nga Valon Murati. “Të kujtojmë se organizatat politike të cilat u angazhuan për organizim luftarak në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, e ftuan popullin në luftë për liri dhe i prinë asaj lufte. Por këtë e bënë pas analizave historike dhe të gjendjes faktike të kohës, të cilat çuan në përfundimet se lufta është e domosdoshme nëse duam ta fitojmë lirinë dhe, e pashmangshme, për shkak të rrethanave. Prandaj, thirrja për organizim luftarak, edhe pse e dhimbshme për çmimin që duhej paguar, ishte e drejtë dhe, me ndihmën e miqve, doli edhe e suksesshme”, ka theksuar LB-ja.

LB-ja ka shtuar se si rezultat i asaj lufte në vitin 2008 Republika e Kosovës u shpall e pavarur. “Mirëpo, edhe para vitit 2008, sikurse deri më sot, veriu i vendit nuk qeveriset nga Qeveria e Kosovës. Në muajt e fundit temperatura politike rreth dialogut, e cila e nxeh më së shumti veriun, është ngritur shumë. Pyetja kryesore e këtij



momenti, e cila rishtrohet, është: a është e mundshme zgjidhja paqësore, apo duhet ndërhyrje me forcë në veriun e vendit për ta ushtruar sovranitetin?”, është theksuar në reagimin e LB-së. Kjo parti ka theksuar se duhet të përgatitemi gjithmonë dhe sa më mirë që t'iu përgjigjemi situatave të cilat edhe mund të çojnë në konflikte të armatosura. “Por këtë gatishmëri nuk e dëmton

vlerësimi dhe deklarimi i qartë e i zëshëm se situata aktuale në veriun e vendit - dhe përgjithësisht çështja e pazgjidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - është çështje politike dhe se mund të zgjidhet me marrëveshje paqësore. Kjo gatishmëri dhe ky vizion politik sot është në përputhje edhe me rrethanat ndërkombëtare e me qasjen që kanë partnerët kryesorë ndërkombëtarë të Kosovës. Dhe pas këtij vlerësimi

e deklarimi, politika të angazhohet fort dhe sinqerisht për këtë zgjidhje”.

LB-ja ka theksuar se zgjidhja paqësore dhe e qëndrueshme është futja e Kosovës Lindore në dialog, me kriterin e reciprocitetit të plotë ndërmjet veriut të Kosovës dhe Kosovës Lindore, që nënkupton reciprocitet prej të drejtave elementare e deri në ripërcaktim të kufirit Kosovë - Serbi. “Forcat politike në Kosovë duhet ta

ndalojnë demonizimin e kësaj mundësie për zgjidhje, e cila është e vetmja zgjidhje në rrethanat aktuale. As Kosova, as ndonjë individ a grup brenda saj, nuk duhet të kërkojë raste që ta shtojë krenarinë në kurriz të dëshmorëve të rinj. Republika e Kosovës nuk duhet të pushojë së kërkuari mundësi që Kosova Lindore ta gjejë zgjidhjen që meriton e me këtë edhe paqe të qëndrueshme”, është thënë në deklaratën e LB-së.

Komisioni për Mjedis hap dyert për profesionistë nga diaspora

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Kryetarja e Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim në Kuvendin e Kosovës, Fitore Pacolli, ka nënshkruar marrëveshje me përfaqësuesen e organizatës GERMIN, Sihana Bejtullahu. Qëllimi i këtij bashkëpunimi

është mbështetja e punës së komisionit me ekspertizë nga GERMIN përmes angazhimit të ekspertëve nga diaspora. GERMIN ka një rrjet të gjerë të profesionistëve në lëmenj të ndryshëm të interesuar t'i transferojnë njohuritë e tyre në institucionet e Kosovës.

“Komisioni për mjedis, ushqim, bujqësi, planifikim dhe zhvillim ka nevojë për profesionistë nga diaspora në të gjitha fushat që mbulojmë, prandaj nga sot komisioni po i hap dyert për profesionistët tanë nga diaspora”, ka shkruar në “Facebook”, Fitore Pacolli.



MEHMETKRAJË LLAZANSKI



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

A po forcohet pjella politike e Rrahman Morinës: Themelues të LDK-së llogariten Mehmet Kraja dhe Jusuf Buxhovi, në bashkëpunim me Rrahman Morinën. Atëherë, Rrahman Morina para UDB-së së Serbisë dhe piramides politike serbe mbronte qëndrimin se duhet të regjistrohet LDK-ja si parti politike sepse ka kërkesa më të moderuara politike, do ta kemi më lehtë ta kontrollojmë dhe, nëse nuk e regjistrojmë del një parti që ka kërkesa shumë më të fuqishme politike dhe të cilën do ta kemi të pamundur ta mbajmë nën kontroll. Nëse e lexoni programin politik të LDK-së të asaj kohe kërkesa ishte që Kosova të jetë republikë brenda federatës jugosllave apo, rikthim në një autonomi para se ajo të suprimohej dhunshëm nga Serbia. Realisht, thuaja të gjithë themeluesit e LDK-së ishin anëtarë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe Serbisë, disa edhe në pozita udhëheqëse sikur që kishin marrë pjesë edhe në diferencimet politike që bëheshin në Universitetin e Prishtinës si dhe në strukturat tjera. Pasi u hapën dosjet në Maqedoni të Veriut, Kroaci, Mal të Zi dhe pjesërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë doli se disa anëtarë të kryesisë së LDK-së në krye Mehmet Krajën paralelisht bënin dy punë; njërin partiake kurse tjetren informative, raportonin në qendrat e UDB-së. Kishin emra të koduar dhe adresa kontakti. Pastaj, bijtë dhe bijat e tyre pas përfundimit të luftës në Kosovë u sistemuan në poste diplomatike në Uashington, Jerusalem, Stamboll, Bruksel dhe qendra e tjera. Mehmet Kraja ishte në Tiranë ku e bëri shylevek skemën e mbledhjes së informatave. Me një përvojë si gazetar i Nasha Armija (Armata Jonë) në ish-Jugosllavi, dyshohet i rekrutuar nga KOS-i dhe pastaj në Zyrën e Kosovës në Tiranë kishte mundësi të mbledhë informata për të gjitha zhvillimet në Shqipëri dhe në Kosovë, si për ato legale ashtu edhe ilegale. Menjëherë pasi dola nga burgu në vitin 1990, bashkë me patriotin e Madh, Ahmet Haxhiu, në koordinim me Bacën Adem, Llapqinin dhe Dulin bënim plane dhe lista për ushtrime ushtarake në Shqipëri. Pas një kohe të shkurtër morëm një informatë nga bashkëpunuesit në Tiranë se dikush po i dekonspiron ato lista

pas së cilave pati arrestime dhe për një kohë u ndalën këto grupe. Tash, në një intervistë të një zyrtari të lartë të UDB-së me gazetarin Idro Seferi në Beograd, ky tha se kishin depërtuar në radhët e atyre që bënin organizime për stërvitje ushtarake duke përmendur Mehmet Krajën, me emër dhe mbiemër, kryetarin e tashëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Agim Gashin, avokat, në mes të tjerëve, si informator të UDB-së. E tash, ky farë Mata Hari i gjinisë mashkullore të bëhet kryetar i Akademisë që, përjashtuar Kosovën llogaritet si ajka e kombit ndërsa në Kosovë nuk është as hirra. Mehmet Kraja është pa ndërgjegje, pa moral, i keq dhe servil, deri në b.lëpirje. Kështu ka mbijetuar para lufte, kështu ka mbijetuar gjatë luftës dhe po bënë shtatë palë qejfe si kryetar i ASHAK-së, me dy identitete, si kosovar dhe me të kaluar aspak të mirë, nëse e shohim trajektoren e tij. Madje, nëse ndaj Rrahman Morinës ka demonstruar servilizëm duke i shërbyer qençe mund edhe të arsyetohet nga frika për jetë por, si të arsyetohet ky prostitucion i tij intelektual para qeverisë aktuale dhe qeverive tjera për aq sa ka pasur dhe ka interes? Se ky farë hermafroditit moral dhe i mjerë ka nevojë për Albin Kurtin, kryeministër edhe kuptohet por, nuk mund ta kuptoj pse Albin Kurti paska nevojë për këtë llum njerëzor dhe antikombëtar, me një të kaluar shumë të dyshimtë! Mos dashka që ky farë gazetar i Nasha Armija (revistë e ish Armatës Popullore të Jugosllavisë) ta fisnikërojë biografinë e kryeministrit Kurti duke i krijuar një vend në histori e cila, megjithatë ka ikur për disa procese, madje ato kryesoret? E mjerë do të ishte historia që do ta shkruante Mehmet Kraja, i dyshuar si agjent i KOS-it (Shërbimi Kundërzbulues i Ushtrisë jugosllave) dhe agjent i UDB-së, sipas intervistës së Idro Seferit me një oficer të UDB-së. Po të ishte bërë me kohë lustrimi i figurave publike sikur që ishte bërë në Maqedoni të Veriut, Slloveni dhe në Kroaci, Mehmet Kraja, ose do të përfundonte në burg ose do të punonte si përkthyes në ndonjë zyre të UDB-së në Beograd, nëse do ta tërhiqnin me kohë në Serbi punëdhënësit e tij. Në rrethanat e tashme, Mehmet Kraja po i bënë konkurrencë, si analist politik

Fatmir Sheholit i cili, (Fatmiri) është shembull ndershmerie krahasuar me Krajën për faktin se ai gjithmonë e ka pranuar se ka qenë pjesë e strukturave informative të Serbisë kurse Mehmet Kraja flet se është vetëm nën thjerrëzën e dyshimeve, duke mëshehur këmbët dhe bërë përpjekje të ndërrojë lëkuren sikur gjarpri i kapur në thera. Sa i poshtë!

Raporti "analitik" i Mehmet Krajës, më i dëmshëm se raporti i Dik Martit: Ky raport është 38 faqe dhe disa rreshta. Ka shumë gabime gjuhësore që nuk do t'i bënte as Akademia e Hajkobilles. Përdor shumë shprehje të huaja, që, në disa raste ia ndryshojnë kuptimin dhe për ta mbuluar analfabetizmin intelektual për ata që e kuptojnë dhe për t'i lënë pa tekst apo për t'i mahnituar analfabetët funksional. Se unë mund të bëjë sikur që edhe bëjë gabime gjuhësore është thuaja normale për faktin se shumë lëndë në shkollën fillore në Podujevë i kam patur në gjuhën serbe, në shkollën e mesme të mjekësisë edhe më shumë kurse në studime 100 për qind në gjuhën serbokroate. Po se këto gabime t'i bëjë apo t'i bëjnë profesorë të gjuhës dhe letërsisë shqipe, shkruantarë apo ata që janë shkolluar në gjuhën shqipe, nuk ta kanë mendja e shëndoshë! Këta janë kontrabanduar në baza partiake, janë futur nga shërbimet informative dhe kanë mriuzuar tërë kohën kurse të merituarit nuk kanë patur mundësi as të hyjnë në zyrat e kësaj Akademie, fatkeqë dhe famkeq! Ky "raport analitik", sipas një miku tim të mirë është: "fund e krye antievropiane", antiperëndimor, konspirativ dhe pa asnjë argument shkencor, fjalë rrugësh e pallavra kafesh, pa fije turpi, njollosje njerëzish dhe moralizim publik. Zaten ndryshe nuk kanë ditur, kaq dinë! "Ndërsa për Mehmet Krajën thotë se është rrugaç ordiner, b.lëpirës i VV-së dhe pushtetit aktual. Çfarë përshkrimi i saktë dhe romantik për një të dyshuar për spion të shërbimeve të Serbisë dhe Jugosllavisë. Në rrethanat aktuale, Fatmir Sheholli duhet të turpërohet nga Mehmet Kraja dhe, besoj se edhe turpërohet! Respekt Fatmir Sheholli! Nëse ky publikim mbanë nënshkrimin e ASHAK-së, atëherë del se një i dyshuar si informator i Serbisë, paska vënë në lojë kundër Kosovës, kundër

shqiptarëve, kundër luftës për liri, kundër viktimave civile dhe heronjve të kombit, kundër ish-të burgosurve politikë dhe kundër Shqipërisë disa ish bashkëpunues të tij dhe pjesën e përfunduar për të bëmat e këtij të stërkequri i kontrabanduar si i pari i Akademisë. Deri më tani nuk ka asnjë përgënjeshttrim publik nga anëtarët e tjerë të Amkademisë që e mohojnë autorësinë e këtij pamfleti politik që është edhe faja tjetër e zezë e raporti të Dik Martit - varianti kosovar, të nënshkruar nga Senatori i Kaligulës - Rrahman Morinës në Kosovë, Mehmet Kraja. Nuk ka raport më denoncues, më lëvyrës, me goditje më të ulëta ndaj njerëzve që janë në burg dhe nuk kanë mundësi të mbrohen e që e kanë meritën kryesore për luftën për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar. Nuk ka, së paku deri më tani raport më lëvyrës ndaj pushtetit se ky raport. As ish-kryeprokurori i Gjykatës Speciale, Jack Smith nuk do të bënte raport më të poshtë, më denoncues, më akuzues dhe më paragjykes. Nganjëherë më shkon mendja se këtë raport mund ta kenë bërë punëdhënësit e këtij kerberi të interesave të Serbisë në Kosovë, duke ia dorëzuar si prodhim të gatshëm dhe stërzgjatje të aktakuzës ndaj pengjeve të luftës në Hagë. Edhe 20 dëshmitarë të mbrojtur nuk do t'i hynin në punë më shumë Gjykatës Speciale se ky raport i nënshkruar nga Mehmetkrajë Llazanski.

Po kush ishte Miroslav Llazanski: Miroslav Llazanski ishte një gazetar në ish-Jugosllavi që merrej me analiza ushtarake, gazetar ushtarak që shkruante për Nasha Armija (Armata Jonë) ku punonte edhe Mehmet Kraja. Vërtet kjo ishte Njihova Armija (Armata e Tyre, e Llazanskit dhe Krajës) e jo Armata e jonë. Të punosh për atë gazetë dhe të intervistosh personalitete të larta ushtarake dhe serbe sikur edhe të kesh qasje në objekte ushtarake, tepër të ruajtura, nënkupton që të jeni njeri shumë i besueshëm, sidomos për ata që flasin shqip apo edhe deklarativisht regjistroheshin si shqiptarë. Pa asnjë dyshim se duhet të kesh qenë i rekrutuar nga ato shërbime e që Mehmet Kraja ndoshta edhe ka qenë. Miroslav Llazanski kishte gjak të përzier prej

disa popujve por, përfundimisht, në zinxhirin gjenetik mbizotëroi kromozomi serb. Prandaj, jetoi, veptoi dhe vdiq si serb. Përveç posteve të larta që i kishte në strukturat zbuluese dhe kundërzbuluese, jugosllave dhe serbe, i mëshehur si gazetar dhe analist për çështje ushtarake, Miroslav Llazanski ishte edhe ambasador në Moskë, Rusi. Mehmet Kraja nuk e besoj se i ka mbërri këto nivele të larta që i kishte prekur dhe zotëruar Llazanski. Mund të ketë qenë spion i vogël, me ambicie dhe sherre të mëdha, gjithsesi në dëm të shqiptarëve që kishin përcaktim kombëtar. Mund t'i ketë futur në burg dhe mbase e ka bërë këtë, nëse mbështetemi në të dhënat e patriotëve shqiptarë të arrestuar në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri e që përputhet me kohën që e përshkruan oficeri i lartë i UDB-së në Beograd në intervistë me Idro Seferin. Dikush mendon dhe pret që Mahmetkrajë Llazanski të pendohet për të kaluarën e që e ka shumë gabim. Po të mos ishte kjo e kaluar, Kraja nuk do të ishte këtu ku është dhe nuk do t'i gëzonte privilegjet që i gëzon sot dhe që i ka gëzuar edhe në qeveritë tjera, që nga përfundimi i luftës. Mehmet Kraja nuk e ka problem me fytyrën, e ka të mbuluar me një mjekër të dendur që ia mbulon pafytyrën nën këtë mjekër. Andaj vepron siç vepron. Dhe, krejt në fund, po të mos bënte kështu siç e bëri, pas përfundimit të mandatit nuk do të kishte asnjë mundësi të zgjedhej si opravnik posllova (drejtues i punëve) në Zyrën që do e hapë Kosova pas normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Pëlqimin nga Serbia për këtë post besoj që e ka që tani, ende pa u hapur zyra. Besoj që as Albin Kurti nuk do ta kundërshtojë këtë. Në rastin e Miroslav Llazanskit dhe Mehmet Krajës kemi një zbatim të 100 për qind të meritokracisë, Llazanski si kryesori i shërbimit ushtarak gazetaresk i kishte mbërritur majat për të përfunduar edhe si ambasador ndërsa Kraja asnjëherë nuk doli nga streha e nënbishtit ku e kaloi tërë jetën dhe ndërtoi karrierë, së pari si gazetar ordiner i Nasha Armija dhe, me gjasë të përfundojë si opravnik posllova (drejtues i punëve) i zyrës në Beograd, pas nënshkrimit të marrëveshjes për normalizim me Serbinë. Do të bëhet Petar Petkoviç shqipfolës!

Bankat në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore presin rritje të kërkesës për kredi

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Sipas anketës më të fundit të Kreditimit të Bankës me fokus në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQLJ) të Bankës Evropiane të Investimeve (EIB), rritja e kërkesës së korporatave për likuiditet dhe kërkesa e individëve për kredi banesash kanë sjellë rritje të kërkesave për kredi në rajonin e EQLJ.

Bankat presin që kërkesa e përgjithshme për kredi të rritet më tej gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, megjithëse me një ritëm më të moderuar, ku kërkesat për kapital qarkullues të shoqërive tregtare për t'i mbuluar nevojat për likuiditet tani janë motivi kryesor. Pritet rritje e investimeve fikse dhe segmenteve të shitjes me pakicë, duke përfshirë kredinë konsumatore dhe strehimin.

Bankat presin që kushtet për ofertën e kredisë, të cilat bankat financuese janë të gatshme t'ua ofrojnë klientëve të tyre - të përqendrohen ndjeshëm gjatë gjashtë muajve të ardhshëm. Standardet e kredisë janë



shtrënguar, veçanërisht në tregun e hipotekave, veçanërisht për shkak të efekteve të luftës në Ukrainë, inflacionit dhe normave më të larta të interesit si dhe ngadalësimit të përgjithshëm të ekonomive.

Kështu, kërkesa e fuqishme për kredi do të përballet me kushte më të shtrënguara oferte. Pavarësisht prej parashikimeve, cilësia e kredisë ka evoluar në mënyrë të favorshme gjatë gjashtë muajve të fundit.

Megjithatë, duke pasur parasysh perspektivën e pafavorshme ekonomike, bankat presin sërish një rritje të kredive me probleme gjatë gjashtë muajve të ardhshëm.

Debora Revoltella, shefe e Departamentit të Ekonomisë në BEI, ka theksuar se, pavarësisht prej pritshmërive të pafavorshme ekonomike, bankat në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore raportojnë sërish qasje të qëndrueshëm në financim falë

përmirësimeve të qëndrueshme në financimin e depozitave me pakicë dhe të korporatave.

Revoltella ka pohuar se në vijim, në kontekstin e përkeqësimit të kushteve globale, bankat parashikojnë shtrëngim të kushteve të ofertës dhe po përgatiten për një rritje të mundshme të kredive me probleme. Ajo ka thënë se duke parë strategjinë afatgjatë, grupet bankare ndërkufitare shfaqin synime pozitive ndaj veprimeve

të tyre në rajon, ku më shumë se gjysma e tyre synojnë ta ruajnë nivelin aktual të veprimeve, ndërsa pothuajse një e treta synon të zgjerohet në mënyrë selektive. Megjithatë, 10 për qind e grupeve bankare (krahasuar me zero në valën e mëparshme të anketës) kanë sinjalizuar synimin e tyre për të ulur në mënyrë selektive aktivitetin në rajon. Pavarësisht prej pasigurisë dhe rreziqeve në rritje, shumica e grupeve bankare ndërkombëtare mbeten të sigurt në potencialin e rajonit. Zëvendëspresidentja e BEI, Lilyana Pavlova, ka thënë se roli i monitorimit të bankave përmes një ankete si kjo është vendimtare për të kuptuar se si do të evoluojë ekonomia dhe për të vlerësuar me saktësi kushtet financiare në mbarë Evropën. "Falë përpjekjeve të ekonomistëve të BEI-t, ne kemi një pasqyrë të mjedisit ekonomik të EQLJ-së, e cila do të na mundësojë të ofrojmë financimin e nevojshëm për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme nevojave të njerëzve dhe bizneseve në rajon", ka deklaruar Pavlova.

Dy marrëveshjeve ndërkombëtare shkojnë për votim në Kuvend



PRISHTINË, 23 DHJETOR - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga kryetari Armend Muja, ka mbajtur të premtën mbledhjen e radhës. Ky komision ka shqyrtuar dy marrëveshje të kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim për projektin "Korniza e qyteteve të gjelbra - Eficienca e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë dhe në Prizren".

Marrëveshjet e kredive i prezantoi ministri i Financave, Hekuran Murati, i cili tha se ato kapin vlerën 6 milionë euro dhe perioda e kthimit parashihet të jetë deri në vitin 2032. Të dy marrëveshjet u mbështetën unanimisht nga anëtarët e komisionit dhe të njëjtat u rekomanduan për votim në seancë plenare.

Komisioni në vijim ka shqyrtuar raportin me rekomandime të

komisionit funksional për Projektligjin nr. 08/L-175 për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, i cili mori mbështetjen e të gjithë anëtarëve të komisionit.

Mbledhja ka vazhduar me votimin e raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2021, i cili nuk mori votat e nevojshme, ndërsa u miratuan raportit vjetor financiar i

Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit për vitin 2021 dhe raportit vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2021.

Pas votimeve mbledhja ka vazhduar me shqyrtimin e planit të performancës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2023, të cilin e ka prezantuar kryetari e bordit, Vjosa Gradinaj-Mexhuani.

Pas shterjes së debatit u vendos

që votimi i planit të performancës së OShP-së për vitin 2023 të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Për mbledhjen e radhës u shty edhe shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2021 dhe shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2021.

BISEDË ME HYSEN TËRPEZËN (4)

Me Beligard, kurrë jo; me Shqipëri, sot

Rugova, qysh e ka sabotuar luftën, edhe tash po bën ashtu?

– Po unë, pse po flas? Tani unë e di kush e pruri Rugovën! E kam marrë vesh krejt. Edhe ti e di. Këta që nuk e humbën asnjë mashkull, që enden andej e kënde, u bënë milionerë. Këtij nuk i ka hup as një pulë. Po gabojmë një gjë. Duhet të vendoset disiplinë. Mos të vriten burra e gra e ta prishim shtëpinë.

Po, shiko, axha Hysen. Këto që po ndodhin, që po i dëgjon, kanë hyrë prej Shqipërie. Mafia shqiptare e ka pasur Gjermaninë në dorë, edhe Bratisllavën në dorë?

– S'po mundem unë, bre! Unë të njoh ty, Sami. Të njoh që digjesh flakë për patriotizëm. Një fjalë po ta them: unë po qëndroj hala. Ja sot, ja kurrë! Amerika nuk thotë mos e formoni qeverinë.

Po i ka thirrur atje Amerika...

– U kam thënë edhe unë, bëhuni bashkë.

Amerikanët u thonë bëhuni unikë.

– Si shkoi Ollbrajti, si shkoi ky, ai po do ta bëjë Shqipëri krejt. Tash gjashtë muaj, këta nuk bëjnë asgjë. Vetë Rugova i ka fajet. Amerika i ka thirrur. Në Amerikë kanë shkuar. Rugova nuk u shkoi atje hiç. Kanë shkuar do të LDK-së. Ata i ka thirrur ai Instituti për Paqe. U ka thanë të bëhet një tryezë e rrumbullakët. U çua ai amerikani e foli, e ky Rugova nuk u ka dalë të bisedojë. Thjesht është duke e shantazhuar luftën. Qëllimi i tij është që shqiptarët të mos jenë të një fjale. Të thotë vetë i kemi dy qeveri. Por, ashtu s'po ta pranohet asnjëherë. Qe gjashtë muaj që jemi, Kosova nuk ka qeveri as ligje. Atë Rugovën e kam frikë, se asht dorë e shkaut!

Atij Franca i ka dhënë më së shumti shpërblyme...

– Po, po. Franca ia ka qitur librin frëngjisht Rugovës. Kush e ka paguar ma shumë se Franca? Franca ka bërë shantazh. E qitën amerikanët në senat. Diversion në mesin e NATO-s ka bërë. Ajo ka penguar NATO-n për t'i sulmuar pikat kryesore të ushtrisë serbe. Vetë Franca, mike e vjetër e Serbisë.

I kam do shenja (mirënjohje) që m'i ka dhuruar hallku. Ai i ke parë?

Shqipëria i pëlqen Amerikës. Se po sigurohet kufiri, a po e di. Profesor Abdi Baleta ma ka çuar një shenjë. Ai ka qenë ambasador në kohën e Enverit.



Ai i ditke punët e mia krejt.

Rugova s'ish mirë as me intelektualët e Kosovës, as me studentët e Kosovës, as me rininë, as me partitë e tjera të Kosovës. As me të burgosnit politikë nuk ka kaluar mirë. Nuk ka kaluar mirë as me Sali Berishën. Kështu shkruan në gazetën Zëri, Hydajet Hyseni.

– (Qeshet Hyseni) Gazeta a?

Mirë, as para luftës, as mbas luftës hiç! O Axha Hysen, ti po thua se nuk ka dalë të shkojë te familja e Adem Jasharit. A e ke dëgjuar ti ndonjëherë që ia ka zënë goja fjalën UÇK?

– Jo, kurrë, jo!

Beogradi bile thotë takozvana (e ashtuquajtura) OVK-a. Edhe Naim Jerliu është në kryesi të LDK-së, edhe ai po thotë UÇK. Edhe Milazim Krasniqi ka qenë me LDK, po u bë me UÇK-në dhe me Hashim Thaçin. Të gjithë po e pranojnë UÇK-në. NATO-ja e Solana – po. Anglia – po, Kuku – po, Toni Bleri – po, Gjermania –

Shrëderi – po. Krejt po e pranojnë dhe po e njohin, kurse Rugova s'po e njeh. E unë ua bëra: s'po e njeh edhe Beligradi edhe Moska, edhe Athina! Po ky, çka ka se? Atëherë ky qenka me ta?

– S'ka fjalë! Ai është duke e luajtur një lojë. Kam thënë edhe më parë. E kam provuar. Po të them edhe ty. Rrotkopuk je edhe ti. I merr vesh të tëra. Më fal! Nuk u vra Fehmi Agani pa dijen e këtij. A e kam mirë, a jo?

Zekria Cana me tha një ditë. Nëse nuk u vra me dijen e tij, ka mundur të shpëtonte Fehmi Agani.

– Ma ka thanë njëri se Fehmi Agani, pa u vrrarë, pa vdekur, paska thënë se Rugova për çështjen e Kosovës ka falimentuar. Ata e morën njëherë e burgosën. Ia lanë UÇK-së njëherë. Po u mor vesh brenda një dite. Serbia tha e ka vrrarë UÇK-ja.

E tash Bukoshi i ka bllokuar ato pare. Është një person ky Shatri, bre. S'po ndihet i gjallë Xhafer Shatri.

Shoq yni i vjetër, shoq e kemi pasur.

– Po de! Çka u bë puna e tij?

Në Prishtinë ka ardhur. Po e nxjerr një gazetë, "Pasqyra". Me një shok po bëj llaf: Për çka është ajo gazetë, për t'u parë në pasqyrë a? Faqet e zeza për t'i nxjerrë në gazetë apo dikë tjetër për ta nxjerrë në pasqyrë?

– Po të kuptoj! Po nuk e di pse u izolua! Ku rrëshqiti ky njeri, bre mixhë?

Eee, axha Hysen, UÇK-ja nuk ka pasur më armik e ma kundërshtar se këtë njeri. A ka qenë Xhafer Shatri ministër i Informatave? Shtabi i UÇK-së ka dalë me komunikata e ky i ka censuruar! Edhe FARK-u është dorë e tij dhe e Bujarit. Forcat e armatosura të Republikës së Kosovës. A ke dëgjuar për FARK-un? Xhafer Shatri ka pasur nevojë për ty e jo ti për të! A të ka ardhur ndonjëherë?

– Ai ka këqyrur e është mësuar prej meje! Po çuditim! Pse s'ka ardhur të më shohë, qysh e ka

pasur punën nuk i jap rëndësi, po i humbi emri krejt.

Ia ka humbur vetes emrin?

– Ky rrëshqiti diku si në lëvore të bostanit.

Moti ka rrëshqitur, por vonë e ka parë! O Axha Hysen, ky ka qenë ministër i Informatave në qeverinë e Bujarit. A ka rrëshqitur edhe Bujari? Pse të mos rrëshqasë edhe ky?

– Ata me Bujarin janë dakorduar!

Ata janë prishur në fund, pastaj kinse dha dorëheqje?

– A ka dhënë dorëheqje, a?

Po, tash një vit! Një vit e dhjetë ditë i bën që ka dhënë dorëheqje. A s'po e ditke a?

– S'di, valla! Pse të të rrej!

Po, ka dhënë dorëheqje. Në nëntor ka dhënë dorëheqje.

– Këqyre, allahile, për politikë, a?

S'po dua të jem me këtë qeveri e me këtë politikë. Kjo nuk po bën çka po dua unë. Është dashur të bëjë kështu. Ky faktikisht ka dashur ta lajë veten. Ky ishte në kontakt me Bukoshin.

Po, ministër i Bukoshit ka qenë. Xhaferi jeton Gjenevë.

– Kam pas dëgjuar se për pare janë gjuajtur me armë aty brenda. Një punëtor që plagosur aty. Jo Xhaferi, po një punëtor i tij. Edhe unë i bëra telefon njëherë. Kujtonte që i ha unë këto punë. Po, more Hysen, më tha, serbët i bëjnë këto. Mbasandaj, edhe një herë më telefon më duket, i thashë: unë jam plak, po serbët nuk i kanë bërë ato.

Kur ta vendosin serbët, e kryejnë atë punë?

– E kryejnë atë punë. Te shqiptarët ka nisur të vrasë dikush.

Ai vetë i ka inskenuar ato.

– Për reklamë. Të them të vërtetën, letrën e parë kur ua kam shkruar, po bëhen shtatë vjet a tetë. Unë shkova. Ai ma gjeti një njeri të shkruante anglisht. Ai e pa që unë kam emër si ushtar, a po kupton ti. S'jam intelektual, po s'po pyet puna për intelektual. Kush jam unë sot? Me qindra ka intelektualë, po letrën time e ka përhapur Klintoni në të gjitha anët. A është kështu, a jo?

Po, po.

– Kur po vijmë amerikanët, më thanë i kemi lexuar ato. Po, po, më thanë, nuk kemi qejf që të

bëjnë keq shqiptarët. Ishte një përkthyes. Disa fjalë i marr vesh edhe unë, por jo tamam. Tha duhet të tregojmë që jemi demokratë. Ne po qajmë për zullumin që po na bën shkau.

Ju edhe vetë keni thënë se, kur keni qenë kryetar, nuk keni lejuar të bëhet zullum. A është ashtu, a jo?

– Po, po, s'ka fjalë.

Gjatë luftës ka pas folur për Drenicë Zekeria Cana, i ka pas dhënë flakë.

– Po ai është intelektual, i fortë bre.

Incizimet në Prekaz, krejt i ka bërë ky Cana.

– Kush më tha dikush se Rugova ka filluar t'i ngushëllojë do nëpër Drenicë?

Kë e ka ngushëlluar? Kurrkënd hiç. S'ka dalë as të shohë. Veç në televizion që ka folur diçka.

– Vallahi, bre Sami, nuk e di. Veç tash po e shoh punën se, çka të vonojë formimi i një qeverie, është keq. Shumë shtete mike kanë qejf që po forcohet Shqipëria etnike. Krejt viset shqiptare. Po forcohet puna.

Ali Shukria na ka mbetur. Ai takimi me të?

– Kam folur me Ali Shukrinë katër orë e pesë minuta. E di Shefqet Peçi, se edhe ai e kish këqyrur sahatin. Në fund, për këtë nuk jam pishman as sot. Me Alinë fola katër orë. I lëmë këto punë krejt, i thashë: Për një pikë dorëzohem dhe e dënoj veten me vdekje në këtë vend para jush. A fitoi komunisti? Fitoi. Pse të mbeten viset shqiptare të ndara?! Të bashkohen me Tiranën. Nëse jo, unë ashtu po e dënoj veten me vdekje.

Unë ju kam dëguar shpesh kur i keni thënë Ali Shukrisë, shkoni e mblidhni një thes gishta e sy. A asht ashtu a jo?

– S'kam lënë gjë pa i thënë. Ani unë s'e kundërshtoj komunizmin. Të bashkohemi me Tiranën, se shqiptarë jemi. Vetëm kështu, unë sot po dorëzohem.

Ti ke bërë luftën që e ke bërë në mal! Na ke treguar për luftën që ke bërë në Ferizaj. Edhe kur ke shkuar në Greqi. Qysh ke dalë në Romë! Kur u bë komiteti i Lidhjes së Prizrenit, edhe në Amerikë kur ke shkuar?

– Mua më keni nderuar, e Zoti ju nderoftë!

Je lodhur. Freskohuni pak e bëjmë pak muhabet të lirë. Bisedojmë edhe më.

– Me çka erdhët?

Ju atëherë në kalë të bardhë e na me katër rrota. Me Agim Çekun erdhëm në Ferizaj, në Gjilan dhe shkua edhe në Kamenicë.

– S'e njoh. S'e kam parë kurrë.

Tash, kur hyri partizani, ju ishit kryetar komune. Çka bëtë ju tash? Filluat të dilni në mal për ta parë punën qysh po shkon?

Puna shihej. Do të shkatërrohej puna. Unë e kisha vendosur. Edhe po ta dija që nuk mbetet asnjë, të luftojmë. Mendimi im ishte të luftoj vetëm deri në fund. Po më duket i kam treguar këto Samiut.

Po Samiu jam!

– Ti e di se unë kam ndenjur në shtëpinë tuaj, se nuk guxonin të më mbanin të tjerët. S'kanë faj! Të ligshhtë jemi! Duhet t'i bihet, bre mixhë. Gjithmonë, tutu, tutu, nuk bën.

Si dolët në mal?

– Na mbetën si pahiri tre englezë. I kishte pas zënë gjermani nga Maqedonia.

Me datë 14 nëntor unë e kisha nijet ta lija komunën. Pushohet, se po hyn komunizmi! Po dua t'i heq prej aty, në komunë, i kam do letra me rëndësi që të mos bien në dorë. Bile i kam marrë e i kam qitur në mal ato letra. Kur një telefon xërrrr... Kur e hapa telefonin. Më tha kush je ti? Thashë: Hyseni, bre! Po thotë unë jam Ramiz Cërrnica! Ka qenë dy vjet më i madh se unë. Mos vet për ne! E kam pas dashur shumë. Më përtej nuk di çka të them. Edhe nuk ka qenë shqiptar i keq. Po kushedi! Tha e mora një telefonatë prej Vllado Popoviqit, se ti Ramiz edhe kryetari i Pozharanit, mos i lëshoni komunat, se jeni besnikë të shtetit. Unë menjëherë e kundërshtova. Hajt, thashë, aga Ramiz, bre! I thashë një fjalë e një besë kemi e qysh i kemi punët. I thashë edhe që bëhet Kosova ujë krejt, unë pa luftuar nuk e lë. Ia mbylla telefonin. Po avitet akshami! Kur po i shoh unë tre ushtarë me tri mushka me mitraloza mbi samar po kalojnë. Unë thashë janë ushtarë, po shkojnë për Ferizaj. Kur hyri një polic e më tha ushtria e lëshoi Gjilanin. Mos, bre! Unë e kap telefonin. E kisha një Ramiz Beguncën, e pata çuar në Stubëll si postëkomandant. Në telefon po i them: ai i ke xhandarët aty? Po, tha! I thashë dil në udhë. Mos bëj pushkë me ta. Tre ushtarë vijnë. Me tri mushka, mitraloza e fishekë plot. Nga një mitraloz mbi samar. Thuaju, vëllezër, ndaluni, se ne do të luftojmë. Mos u ndalshin, ndaloni mushkat dhe armët me fishekë. Pushkët mos ua merrni.

Shqiptarë, bre, më ardhke keq t'i çarmatosin shqiptarët, mozomakeq. Kishim boll armë. Ai u del përpara. U thotë se ka urdhër. Ushtarët i lëshon, por ua ndalë mushkat, armët me fishekë.

U nisa për Gjilan. Me çeze. Jam veç me një polic. Kur kam dalë te Radivojca, qe dy kamionë me ushtri, po koloneli vetë asht me shoferin përpara. Kamioni tjetër është me policinë shqiptare. Më ka parë mua koloneli. Atje isha përditë. E kanë ndalur kamionin. Pa u afruar unë hala mirë, ka zbritur dhe ia plasi vajit. S'po mund e pajtoj tek dënes. Na mori shkau, po thotë. Ndaluni, i thashë, se veç prej Zotit vjen diçka. Unë tha kam urdhër të hyj sonte në kufi të Shqipërisë. Tha mos u mërzit. Krejt Kosova po mbeti me ta, malet e Shkodrës nuk bien. Fjalë të shqiptarëve! I thashë këtu jemi në hall! Nuk mund ta mbrojmë këtuhen prej maleve të Shkodrës. Bre, lut e lut, s'ndalet. Po, tha, lidhjen e ke me djalin e Ramë Bllacës, Qazim e ka pasur emrin! Me Qazim Bllacën! Merru vesh, ai është në Prizren! Do të jemi në lidhje gjithmonë. Udhë e mbarë! Mbarë paç! Nisën të mblidheshin aty menjëherë. Po vijnë do prej Sllatine, do prej Zllatari, me pushkë në dorë. U ktheva në komunë. I dogja do farë letrash çka kishin rëndësi. I shpërndava do për politikë. Njëri ka qenë aty, por ka vdekur në Itali. Ka qenë i Pozharanit, azgan shumë. Kur kam dalë në xhade për ta lëshuar komunën për të shkuar në Tërpezë, i kisha çuar fjalë Hasan Kabashit t'i binte tek unë anglezët. Kur kam dalë në xhade, i vëllai i Sinan Hasanit, Musli Pira, afër tij, mbas Rifat Pira, tha: Ku je tradhtar, bre!

Mua?



Ty!

Papë unë koburen. Po edhe ai e kishte koburen!

I bërtiti Musliu. Ai polici qe afër meje. Menjëherë ra dhe ua ktheu pushkën. Ah, kush jeni ju, he jua bëfsha e jua kthefsha, bre! Pat m'i stërvajtë, valla. E ndalen atë! Po avitet akshami! Kur shkua në aksham, u terrua pak. I pruri anglezët aty! Erdhi edhe Mulla Idrizi i Gjilanit. Erdhi me nja 4-5 veta edhe ai. Tri shtëpi i kam pasur, Edhe për të luftuar mblidhen njerëzit. Po vijnë krejt katundi. Po vijnë njerëz edhe prej Sllakovci.

Muharrem Fejza i Hogoshtit, a ishte aty?

– Ai ka qenë i flaktë. Shtëpitë e xhandarisë së Tërpezës kanë qenë mbi katund. Kanë qenë shumë japia. Njerëzit që u tubuan, shkuan aty. Unë mbeta me shokë për të parë se bahen shumë njerëz. Ata mbetën atë natë tek unë, edhe dy net. E gjetën njëfarë djali prej Gjilani. Ata patën ndenjur tre muaj në Hogosht. Ai ditke nga pak anglisht, por jo mirë. Merrte vesh ky djali. Ata englezët thoshin këtë regjim nuk e do Amerika. Ne jemi ushtarë e nuk dimë tjetër, por anglezi nuk e donte këtë regjim. Tri net aty, te na. Mulla Idrizi e Muharrem Fejza po thonë: mos po na i zënë në dorë anglezët? I dorëzua ne në Gjilan. Ia dhanë dikujt t'i çojë. Mua më tha mulla Idrizi të dilja nga Ferizaj. Merre ndonjë polic e dil. E mora atë Sadikun me dy kuaj, se kishim boll që i kishim zënë në Maqedoni. Luftë e madhe qe bërë atje. Kur kam dalë, kur njëri po thotë, qe Adem Gllavica. Një herë e kisha pa a dy, se ai ka qenë në shkollë. Kur shkova ai kish qenë duke ua



ndrequr kapuçat për t'i bërë partizanë. Edhe kish vendosur të hynte në Ferizaj, të shkonte me ta. I thamë, zotni Adem (ai ishte më i ri se unë nja katër-pesë vjet). I thashë eja në vete. Ai s'po ndalet. Ai ka marrë hov. Kur kanë dalë prej Ferizajt, nja tre a katër duke ikur. Po ikin, asnjëri shoqin s'po mund e zë. Çka keni bre? Tha vallahi e rrëzuan flamurin tonë, e vranë një ee...! Veç u ndalën. Po i them, a po e sheh. Kur e pa situatën, i thashë te ne po mblidhemi. Pari kemi boll. Mulla Idrizi është aty. U avit akshami. Ani, tha. Nesër e mbledh edhe ndonjë shoq e po vij. Edhe të nesërmen erdhën, besa. Tridhjetë-katërdhjetë veta. Po mblidhen mileti. Pa rrena, a janë kanë tre mijë veta, eksik dyqind a jo. Po rrimë aty. U çua pastaj Mulla Idrizi e po thotë unë po shkoj edhe një herë nga Gjilani. Të nesërmen një telefon cingëron. Ka ardhur një njeri me një letër në dorë e po pyet kush është Hysen Tërpeza? Krejt letra serbisht. Megjithëse unë s'disha të këndoja as shqip as serbisht. Ia dhashë Muharrem Fejzës e po e këndon. Edhe Ademi pat ardhur aty. Shkruan Hoxhë Nishevcu. Kish ardhur me brigadë me 5 mijë veta në Gjilan. I kanë kallëzuar që unë kam vendosur të luftoj.

Thotë serbisht në letër. Mbas ke vendosur t'i biesh Gjilanit, po t'i çojmë disa mijëra yje. Nëse e vë yllin në ballë, nuk e ke vënë në zemër. Zini rrugën e Prishtinës me nja 2 000 veta. Zini rrugën e Shkupit. Në Gjilan bërtitni Rrnoftë Marshall Tita! Rrnoftë Enver Hoxha! Edhe e merrni pushtetin në dorë, pa gjak. Të fitojmë luftën, mos ta humbim! Krejt në emër timin.

U them nuk kemi asnjë marrëveshje. Këto toka janë toka shqiptare e nuk kemi asnjë bashkim me serbë. Shkruaje. Ia kthym letrën.

Të nesërmen një djalë po pret aty. Kush a ky? Të nesërmen shkruan Vllada Popoviqi, serbisht, një letër.

Ju e dinit që kishte shumë brigada? E dinit që Ferizajn nuk mund ta merrnit, por donit t'u tregonit shqive që këtu jemi.

– Duke u çuar, këta e kanë marrë Adem Stançiqin. E kanë thirrur atë të Muçibabës, Imer Muçibabën. Ai e ka dhanë fjalën. Ai ka shkruar i ka kallëzuar katundit se u lidhëm. Sonte a nesër vjen brigada prej Preshevës e t'ia zëmë rrugën. Aty çojnë një njeri që t'u thotë mos u ngutni, se do të merremi vesh. Ai Ymeri thotë: çka, bre? Unë edhe po ta di që nuk jetë njeri i gjallë, pa e nisur luftën nuk e lë. U vra ai i shkreti vetë i trembëdhjeti. Këta i morën e i çuan në Gjilan. I kanë lidhur. I kanë detyruar Fazlinë me Ademin të tërheqin qerren si kuaj nëpër Gjilan. Dikur i shtinë në burg. Dikur Ademin e banë

deputet, Fazlinë s'e ngucën hiç. Krejt u dorëzuan. Krejt, hajt, mule, se po merremi vesh. Na more në qafë, mua më thoshin! Vallahi, bilahi, bre mixhë, veç u shkolluan gjinja, se të humbur kemi qenë.

Mbasi u shpartallua lufta në Gjilan e në Ferizaj, ju në mal ishit a?

– Po, ne në mal.

Sa ushtarë i kishit?

– Nuk dihet! Herë 200 e herë 400.

Po ju për Karadak, kush ju emëroi komandant, Shtabi i Kosovës a?

– Jo, more. Ne pritnim të takoheshim me shokë e mos po bëheshim më shumë. E quaja veten të vogël. Unë pa shkollë, pa kurrëgjë. Këta shkollarët mbetën varur. Mos po bëhet me paqe diçka. Kisha do shokë, por ata ishin si unë, pa shkollë. Mbas katër-pesë muajve e kemi bërë tubimin në Presidël. Aty jemi qenë nja 500-600 veta. Kemi pritur. Thosha kush jam unë? E quaja veten fëmijë. Pa shkollë. Turli njeri me vete. Ndoshta po bëjnë gjëra të këqija. Unë mbeta. Kur u mblodhëm në kongres, Ibrahim Kelmendi s'e pranon këtë detyrë. Luan Gashi jo. A e qesim Ademin? Po nuk pranonte.

Tani ju mbeti juve komanda, bacë?

– E qitën në vota edhe Ademin, po votat erdhën nga unë krejt dhe thanë, ia pafsh hairin! Unë thashë: ngadalë, se do t'i caktoj më edhe komandantët. Caktuam për Kopilaç Hasan Kabashin, komandant i parë i batalionit. Komandant i dytë i batalionit Rexhep Xhakli i Kishna Poles. Komandant i tretë i batalionit nga ana e Jezercit një Shaban Haliti. Tre nga ana e Prishtinës, Rexhep Akllapi. Ishin edhe ata nja dhjetë kushëri, edhe të fortë për luftë. Për Kaçanik, Dyl Hoxhën. I vjetër, i kish afër 60 vjet. Edhe u besatuam. I dhamë zor. Doja të bënim krejt. Po hyri ilet. Unë kam dalë nga ana e Budakovës, me Ademin dhe Ibrahim Kelmendin. Atë ditë Luanin jo. Ish diku tjetër. I shkruam Adem Jezercit. Ka qenë nga fundi i muajit maj '45. Morëm vesh që po duan t'i tubojnë parinë për t'i shtyrë të nënshkruajnë, se po duan të mbeten me Serbinë. Kam shkruar unë tek Adem Jezerci. E njihja përpara. Ishte njeri që pajtonte gjaqe. Burrë i mirë. E gjetëm. Ishte natë. Vetëm në odë. Me priti e më veti. Unë i thashë çka kemi dëgjuar që po thonë. Mirë paskeni dëgjuar, se na kanë thirrur që dy ditë. Na ka thirrur Fadili në Prizren. Qysh më ka thënë, nuk e harroj kurrë. Na tha shikoni. Do të na thërrasin ne parinë, që ju me një zë të flasim e të themi se jemi me Jugosllavi! Kam marrë edhe një letër, tha,



po letrën nuk na e kallëzoi. Tha kam marrë një letër edhe prej Enverit: sot thirre parinë e thuaju, me të parën fjalë do të thoni – me Jugosllavi! Se po të thotë dikush me Shqipëri, jo veç ju paria që jeni aty, por do të shkojnë me mijëra e me mijëra kosovarë. Na ka zënë puna e s'kemi nga t'ia mbajmë. Çka mund të bëj unë, o Hysen Tërpeza? Ti e ke atë pushkë e të lumtë! Për shembull, Ramiz Cërnica, mend ka pasur, po zemër nuk ka pasur. Ramizi një herë ka thënë, mbasi tek është komunist andej e kënde, atëherë ne po shkojmë me Shqipëri. Po ngadalë, ngadalë, e morën e shtinë në burg me gjithë djalë. Bile djalin përpara. E kam dashur shumë. Kur shkova në Greqi, ëndërr e kam parë që e kanë zënë. Sa herë shkoja në Gjilan mua më ndalte. Shumë muhabet më ka bërë në Cërnice. Kam qenë i ri. Bile u thashë shokëve, ëndërr kam parë që Ramiz Cernicën e kanë kapur.

Çka u vendos për atë plakun e Jezercit?

– Ademi tha çka të bëjmë? S'kemi nga ia mbajmë! Enveri na tha që do të shkojnë me qindra-mijëra krerë të Kosovës e nuk do të mbetet kush. U tradhtuan që u lidhën me ta herët. Unë thashë të biem në kontakt e ta bëjmë Lidhjen e Prizrenit, se kisha mësuar goxha për të. Bile na pat mësuar Halim Orana.

Kam pas dëgjuar nëpër oda më herët për këtë Lidhjen e Prizrenit. I ri kam qenë e pata ndenjor kryetar tri vjet. Edhe pa rënë hala, kam pas kuvenduar me disa shokë për formimin e Lidhjes së Prizrenit. Ka qenë Halim Orana. Atë e kanë pushkatuar në Kroaci. Na pati mbetur Kroacia në lidhje e atë e

patëm çuar të na përfaqësonte. Dy muaj a tre hala ishim duke luftuar në Hogosht, u takua me mua, se shkoja në Gjilan shpesh e në Hogosht. O Hysen, më thoshte, qe besa unë të njoh ty, kemi folur edhe përpara, ka ardhur dita dhe na duhet të mbetemi hala maleve. I thashë unë e kam sosur që kurrkush në mos daltë, unë me këtë pushkë në dorë do t'ia nis. Edhe ata, edhe ne, u morëm vesh, e caktuam që ai të jetë kryetar. E pastaj u mor vesh se atë e kapën. Për Azem Oranën janë të shkruara të gjitha.

Gjatë asaj kohe, kur ishit në mal, brigadat e Shqipërisë patën hyr, a?

Po, po.

Kur u takuat me Ali Shukrinë e Shefqet Peçin? Më herët?

– Jo, jo, më vonë. Ka qenë nga fundi i muajit maj 1945. Ali Shukria ishte në pozitë të lartë, përfaqësonte krejt Jugosllavinë. Malet tona janë të forta. Ne i kemi dëmtuar më shumë. Jemi atje në malet e Gadimes. Verë ka qenë, nga fundi i majit, në fillim të qershorit. Ne kemi vënë rojën. Veç Ibrahim Kelmendin e kam me vete. Ademi e Luani ishin nga malet e Prizrenit. Na jemi nja 20 veta. Gadimja na ka mbajtur shumë me bukë. S'ish kurrëgjë. Na qitshim pushkë në mal. Kur dilnin brigadat, na kallëzonin mileti. E kemi vënë rojën, po rrimë aty. Po bëjmë llaf e muhabet. Shaban Kajtazi ka qenë kryetar në Prishtinë. Ka qenë i lidhur me Fadilin.

Ai Shaban Kajtazi ka qenë shef i OZNA-s. I Babushit ka qenë. Alia, krejt Jugosllavinë e kish në dorë. Përfaqësonte Jugosllavinë. Shefqet Peçi nga Shqipëria... Janë bashkuar dy shtetet, se lufta po shkonte në mbarim, e kanë biseduar qysh të na

mashtrojnë. Ai qe e pat përpara Ukë Sadikin, e vranë atje nga Peja vetë të 23-tin. I kam të shkruara. U vra Nue Përlesh përpara. I fortë ka qenë. I fortë, por pa shkollë. Edhe druri është i fortë, po dru. Edhe puna po shkonte duke u ligështuar. S'u tutshim. E kishim vënë rojën. Këta kanë shkruar e i kanë marrë në Mirash. I kisha edhe do shokë me të cilët kam pas bartur duhan, 7-8 vjet a dhjetë, për t'u bërë idare. Shokë, po të jetesës. Ata nuk mbetën në mal për hesapet e veta. Kur pat dalë njëri prej tyre pak i thashë: Qazim, ju për mua mos rrini. Unë e kam vendosur se nuk dorëzohem derisa të vritem. U dorëzuan ata. Tashti ata i ka marrë Ali Shukria, i ka marrë me vete që të vijnë të dy. I paskan marrë ata të vijnë tek unë.

Edhe Adem Kajtazi edhe Alia e kanë pasur nga një djalë. Ka qenë një Brahimi i Rrahim Cërnillës, ngjit me Babush e me Mirash. Aty e kemi pasur një njeri që ka qenë zotni, muhabetxhi i madh. Më ka dashur. Ish i vjetër, i kishte 60 vjet, e unë djalë i ri kundrejt tij. Po rrimë, po bëjmë llaf, këta i kanë marrë Qazimin dhe Qerimin, në Mirash, edhe një tjetër, ka qenë spiun gjithmonë. I Mirashit ka qenë. Ata janë tre. Ata janë në tesha joushtarake, civilë, po me armë. Djali i Brahimit është i veshur ushtar. Kajtazi, edhe ai. I ka parë roja jonë. Ishin do roga nëpër mal. Po i njohin. Vëllai im ish hala pa u vrarë, 20 vjeç. Ahmeti, kushëri im, i ka njohur ata. Kanë qenë disa herë në shtëpinë time ata të Mirashit. Edhe më kallëzuan mua. Paskan thirrur ata, e paskan parë vëllanë tim. Qazimi ka ardhur, shko thuaj Hysenit, me besë, që unë jam Shaban Kajtazi e na njihni. Kur erdhën, ç'të bëja, tek të bëja. Thashë, le të vijnë, more! Në mal pushkën në dorë e kam. Kisha automatikun. Nuk e merrja fort me besim, se mu nxeht fort ajo armë, nuk e qet plumbin sa në derë. Pushka është shumë e fortë. E kisha një çekoslllova. Le të vijnë, bre. Po kanë qejf të takohemi. Shtatë veta, tre kushërinj të mi e do të tjerë. Ka qenë një Rexhep Behluli, nip i Bajrush Xhaklit. Ata shqiptarët janë trima krejt, por ai ka qenë shumë i shpejtë. Nga shkoja e marrja me vete. Aq ka qenë i rreptë, sa tre veta i çarmatoste për një minutë. Thashë rrini gati ju. Po vijnë ata. Janë Shaban Kajtazi, Ali Shukria dhe kanë edhe një serb me vete. Shqipen e ditke si bylbyl. Mirë se erdhët! Folëm dorë për dore.

Shefqet Peçi, nuk ka qenë me Aliun herën e parë?

– Jo, jo. Shefqet Peçin e kanë lënë në odë. Po, more, jam takuar pastaj me të.

U përshëndetëm me ta. Shabani tha: O zotni Tërpeza, si me frikë po thotë: dy shtete janë marrë

vesh, kanë garantuar, çfarë duhet të flasin me ty, çka duhet të bisedojnë me ty. I thashë punët janë të ndara, hala nuk po e shihni, a? Valla ne nuk e dimë. Qe Qazimin e Qerimin që i ke shokët më të dashur. Të takohemi në odë të tyre. S'kisha more çka të flisja. Tha s'kemi më takime. Janë ndarë bisedat tona. Shqiptarë, tha, jemi, zotni Tërpeza, e nuk duhet të frikohesh. Kur ma tha këtë, "nuk duhet të frikohesh", mua më dogji kjo pak. Mos, bre mixhë, se ti je shqiptar vetë, se nuk frikohen shqiptarët. Ai po thotë në Mirash, thashë, po mbasi po e përmend frikën, thashë unë jam gati të vij edhe pa besë, pasha këta dy sy. Në dash në Ferizaj, në dash në Prizren, në dash në Pejë a në dash në Gjakovë. Unë njoh zot dhe i jam mbështetur kombit. Çohuni ku të doni, jo se në Mirash.

A kishit ju ndokënd me vete?
– Vetë i teti!

Një më shumë?
– Po!

Shtatë shokë e unë i teti. Të betuar për të vdekur. Ne shkuam në Mirash. Kur hymë në odë të Qazimit, asnjë njeri aty. M'u avit Isuf Dobraja, ish pak më i moçëm, nuk ish budallë. Tha na prenë në besë, bre! Thonë se Shefqet Peçi është aty duke pritur. I janë avitur atij Shabanit dy djem të rinj. I paskan çuar prej Sojevs, se më moti edhe i paskan thënë Shabanit që ata na kanë çuar, e hajdeni atje e më mirë bisedojmë!

Në Cërrnillë?

– Po, po. Unë mos të kisha thënë fjalën e madhe, që në dash në Prizren a në dash këtu, s'po shkoja, po fjala me shtini ngushtë. Isufi u avit e tha, na

prenë në besë, bre! I thashë, Isuf, kam folur fort dhe asnjëri mos ardhshi, pa shkuar vetë nuk e lë.

Jo, tha, ne nuk ndahemi. Hajde. Ma gjetën edhe mua një kalë. Shefqeti dhe djali i Brahimit kanë ardhur me kuaj prej Cërrnillës, a po di. Tre në kuaj, një kënde, një kënde. Sahati gjashtë allaturka të ditës. Nxehtë. Ishte muaji maj. Afër aty, s'ka pesë a gjashtë minuta. Shabani thotë, s'ka tjetër aty, përveç tre-katër policë. Veç Ali Shukria është. Dikush po prashit. Ahmeti e Sejda, kur na panë, u habitën. Unë në kalë. Djali i Brahimit ushtar i veshur. Komandant ish Shaban Kajtazi. Puna e mbarë! u thashë. Ai njëri po do të ma japë një cigare e po i dridhet dora të ma japë zjarrin. Ahmet, i thashë, tash kthehem. U ndalën.

Kur po bëjmë të hyjmë në Cërrnillë, i binte si breg, e po këqyri, kur çka të shihje në oborr? I pashë si në tepsi, në oborr të Rrahimit. Çka do të bësh? Neve na thanë janë dy-tre ushtarë, Shefqeti e Alia janë, edhe një serb, shoq me ta. Nga t'ia mbaj? E kisha vendosur të takohesha me ta. Kisha vakt edhe të kthehesha. Ishte terreni ashtu me brigje. Aty janë njëzet a ma shumë a tridhjetë veta. I pashë, do ruhen, s'di çka bëjnë. Plot oborri. Thashë me vete, këta që i kam në të majtë, po i fshij. Ata na kanë parë. Kur kemi hyrë në oborr atje, kanë dalë. Alia kish qenë atje. Oda aty, shtëpia sikur përtej. Shtëpia dy kat. I kanë çelur dyert e oborrit prej dërrasave. Kemi hyrë aty. Alia ka dalë përpara. Mirë se erdhe, zotni Tërpeza! Mirë se ju gjeta!

Edhe Shefqeti tha hajde, hajde urdhëroni! Hymë. Rrahim Cërrnilla e ka qit një postiqe e u zverdh. Tutet në shpi të tij. Unë

hiç. Pesë pare s'po i jap. Ai ka qitur prush në midis për të bërë kafe. U ulëm aty. Alia tha: Zotni Tërpeza, faleminderit që ke pranuar! Edhe me Shefqetin folëm, si je, ku je dhe jo më gjatë! Mirë që e ke pranuar takimin dhe të na kallëzosh çka lyp? Thashë flisni ju njëherë. Nuk e di çka t'ju them, ju më keni thirrur. Ka vakt kur flas unë. Po, tha, liri e madhe. Fituam. Jemi pajtuar krejt.

Tre-katër mijë veta ishin burgosur. Çka ish bërë në Tetovë, more mixhë!? Monopoli i duhanit që ka qenë në Tetovë ishte mbushur tri herë nga tre mijë veta, e sabahu nuk e ka çelur asnjë. Në Maqedoni kanë bërë më keq se te na që kanë bërë serbët, në Kosovë. U bë luftë, si në Gjilan e në Ferizaj.

Po thotë, po merremi vesh. Shtetet i kanë dhanë karar. Ti, zotni Terpeza, i ke dhënë provat. E vërtetë, ke nisur luftë e është derdhur gjak, po në realitet ne e dimë se ti je burgosur nga italianët e je arratisur prej gjermanëve. Ke bërë këtë e këtë, e ke ruajtur komandantin Fadil Hoxha, e ke shpëtuar. E patëm shpëtuar në luftën e Livoçit. Unë po dëgjoj.

Sot, tha, unë e përfaqësoj Jugosllavinë. Në krah e kishte Shefqetin. Ky Shefqeti përfaqëson Shqipërinë. Dy shtete, dy qeveri, kanë marrë vendim të të falin. Asnjë minutë në burg. Ti je i lirë. Shokët që janë për ushtri, le të shkojnë ta lajnë ushtrinë. Atyre që janë të vjetër, do t'ua lëmë edhe armën. Për ty nuk bëhet fjalë për burg. Ti do të jesh në dorë të hyqymetit. Do të jetosh si është më mirë. Një kohë dhe jo shumë gjatë e mbasandaj do ta kesh vendin përmbi krejt, jo veç në Kosovë, por edhe në Jugosllavi. Po flet, po flet. Një orë e pak minuta ka folur. Atëherë i thashë: a e mbarove, zotni Ali? Po. Pasha Zotin, more mixhë, e ka këqyru sahatin edhe një shoq. Katër orë e pesë minuta kam folur. Me këtë gojë kam qenë i fortë. Tybe nuk më ka rënë në mend që ka tutë në botë. Shokët i kisha përreth të gatshëm të vdisnin. I thashë, me kë po flet ti? Si po bahet sahati nëntë, duke kërcitur pushkët në krejt Kosovën, duke bërë batore njerëzit. Me mijëra njerëz. Duke ia numëruar, çka u bë në Tetovë? Unë jam edhe atje. E di krejt. Unë jam në mal, kaçak. Me mijëra njerëz i kanë mbytur. Nata i errë e sabahu s'i çel. Shqiptarë janë ata, bre. Nuk flet hiç. E mbulonin djersët, por për të folur nuk po fliste.

Shkau, aty po për vete e ka?

– Po, po. A po e sheh atë serbin aty? Po. Ky nuk është komunist, po çetnik. Ky i ka tapitë për tokat që na i ka uzurpuar. Tash e ka vënë një yll në kapuç e kisha jam bërë komunist. Po, bravo i qoftë, bre! Ai e ka detyrë t'i bëjë këto. Ne hala nuk po shohim. Shkaut



një çehre i shkonte, një i ardhke. Shqipen e dike si bylbyl ai. Hiç s'folke Alia. Fola unë katër orë. Po avitej akshami, po unë të tutesha, hiç jo. I ka rënë hija. Diellin e kemi mbas shpine. Dielli po duket vetëm në majë të shtëpive. Edhe po mendoj si do të dal ditën prej aty.

Atëherë thashë, kjo punë është e mbaruar. Vetëm kur të bëhet një Shqipëri etnike, atëherë pajtoj unë. Biseda mbaroi. Thashë, çohemi. Alia tha mos u ngut edhe pak. Jo, tha ai Shefqeti i Shqipërisë. Shefqeti tha, toskë ishte, zotni Tërpeza, unë po të dëgjoj qe je duke folur qe katër orë. Tha krejt je gabim. Dorëzohu tha, se unë e përfaqësoj Enverin, Shqipërinë. Dy shtete i kanë vënë karar (janë pajtuar) që ti je i falur. Çka do tjetër? Edhe ato që foli shoku Ali krejt janë ashtu. Tha ti çfarë kërkon? Unë veç me një fjalë që fola – vetëm vdekjen time mund ta nënshkruaj.

A fitoi komunizmi? Fitoi. Pse të mbetet Kosova me Beligrad? Thashë. Ne nuk pajtohemi në asnjë mënyrë të mbetemi në Beligrad. Edhe nuk pranoj në asnjë mënyrë marrëveshje. Po ndalen fjalët, po avitet akshami. Brigadat në të gjitha anët vlonin. Të merremi vesh, zotni Ali! Kush do të dorëzohet, unë nuk e ndali. Unë veç me një pikë dorëzohem: (edhe sot kujtohem), a fitoi komunisti luftën edhe në Shqipëri? A fitoi komunisti? Po. Pse të mos shkojë Kosova me Shqipëri. Dorëzim nuk ka. Në shokët me Shqipëri, unë po e nënshkruaj dorëzimin tim edhe dënimin me pushkatim. Me Beligard, kurrë jo. E kam bërë njet të vdes me këtë armë në dorë. Tap, kërceu Shefqeti. Tha qe katër orë që fole, krejt je gabim. Ia ngjiti thoit: a ndahet ky thua prej mishit, aq ndahet qeveria e Tiranës prej Beligradit! Mendo mirë, jam i ngarkuar të të kallëztoj gojarisht.

Përfaqësoj Shqipërinë dhe Enver Hoxhën, presidentin. Siç foli edhe shoku Ali, ne i falim edhe jetën dhe krejt. Përndryshe, mendo për farefis. I thashë farefisi im është krejt Kosova! Mendo për familjen personale.

Kurrë në jetë nuk kam qenë më trim! I thashë: shiko, sa për familjen time, njëri djalë ka qenë tre-katër javësh, shko merri e qiti në zjarr, le të digjen, se unë nuk i dorëzohem kësaj diktature. Thashë, me leje, Alisë, se e kisha në krah, ne po çohemi. Shefqeti e zbuti pak zërin. Zoti Tërpeza, tha, mos u ngut edhe pak. Të shkruash një letër e t'ia dorëzosh Këshillit të katundit, le të vijnë shokët, se ty nuk mund të të lëshojmë. Dhjetëshen e Alisë e kam këtu në krah. Kur më kanë shkuar kështu shokët, shkoj edhe unë. Njëri e kish një mashinkë italiane, të fortë. Ia ka kthye Shefqetit në rrasë të gjoksit. Ka bërtitur Alia trishtueshëm. Si të mos kish qenë zë njeriu. Prej këtij vendi, u thashë shokëve, mos luani! Bërtiti edhe Shefqeti. Tha, tashti, me leje, puna mbaroi. Thashë le të çohemi! Shefqeti atëherë kish qenë budallë për mua. Atëherë unë e pashë punën. Alia i bërtiti atij. Ngadalë, se me besë e kemi marrë e me besë do ta çojmë te shokët. Krejt u çuan në këmbë. I rrokëm përpara të gjithë dhe i qitëm para derës. Ku do t'i çosh, axha Hysen? Kishte rënë shi dhe kish ardhur uji prej Gadimes dhe e kishte prerë tokën e kishte bërë llagam të madh. Mal nuk kishte aty. Ishte bërë rovinë e madhe në Cërrnillë. Po ecim ne e s'po bëjmë zë hiç. I kemi rrokur përpara. Kur u avitëm aty, pranë llagamit, thashë, ndaluni, zotni Ali.

(Intervistë e realizuar nga Sami Dërmaku, botuar në librin "Dëshmi kohe" nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Vijnë nesër) /Epoka e re/



Kostoja e manipulimit



Nga Moisés NAÍM

Në fund të çdo viti që nga 2003, Fjalori Amerikan Merriam Webster shpall fjalën angleze të vitit. Sipas fjalorit autoritar, fjala më e kërkuar në internet në vitin 2022 ishte Gaslighting (ndezja e llampave me gaz). Peter Sokolowski, redaktor i fjalorit, i tha agjencisë së lajmeve Associated Press se kërkimet për fjalën këtë vit u rritën me 1,742 për qind në krahasim me një vit më parë. Ishte ndër 50 fjalët më të kërkuara çdo ditë.

Gaslighting është një term bisedor që i referohet trukeve të përdorura për ta bërë një person të dyshojë në realitetin e tij dhe të vërë në dyshim atë që ndjen, beson dhe bën. Qëllimi është që të dobësohet psikologjikisht viktimat për të ndikuar mbi perceptimet, sjelljet dhe vendimet e tyre.

Kjo ide u përdor fillimisht në një shfaqje që u dha si premierë në vitin 1938 në Londër dhe Nju Jork dhe më pas u soll në ekranin e madh në vitet 1940 dhe 1944.

Filmi, "Gas Light", tregon historinë e një çifti ku, për t'i marrë paratë, burri manipulon gruan e tij duke e bërë të mendojë që ajo është e çmendur. Ndër truket e tjera, burri kishte instaluar një sistem për të ndezur dhe fikur dritat me gaz në shtëpi, kur gruaja ishte vetëm.

Gënjeshttrat e vazhdueshme, kontradiktat, konfuzioni, skepticizmi për vlefshmërinë e të vërtetave më parë të padiskutueshme dhe zëvendësimi i tyre me histori të rreme, sulmi ndaj vetëvlerësimit të viktimave dhe stimulimi i pasigurive të tyre, mbajtja e informacionit dhe përdorimi i vazhdueshëm i gënjeshtrave janë vetëm disa nga taktikat e përdorura prej manipuluesve.

Termi kishte dalë jashtë përdorimit dhe u rikthye në përdorim me një farë frekuence nga psikologët dhe psikiatrit në mesin e viteve 1990, por rritja shpërthyesë e shpeshtësisë me të cilën kërkohet fjala sot në internet nuk vjen nga këto fusha, por nga politika, ku gjithnjë e më shumë po përdoren taktikat e Gaslighting

për të formësuar atë që beson një shoqëri e tërë.

Në fakt, Gaslighting lidhet ngushtë me një fjalë tjetër që në 2016-ën u zgjodh nga Fjalori i Kembrixhit si fjala e vitit: post-truth (post-e vërteta), ose prirja për të pranuar një ide si të vërtetë mbi bazën e emocioneve dhe jo të fakteve. Vitet e fundit kemi parë sesi, në shumë vende të ndryshme, opinioni publik ndikohet nga liderët dhe grupet që shpërfillin të dhënat, provat dhe madje edhe logjikën.

Një shembull dramatik i Gaslighting dhe i post-të vërtetës është Brexit. Promovuesit e saj përdorën gjerësisht truket e Gaslighting dhe arritën të krijonin një strukturë të opinionit publik të dominuar nga post-e vërteta. Dihet mirë se kur ministri Michael Gove, një nga udhëheqësit e Brexit, u pyet se çfarë mendonte për një studim të kryer nga ekspertët të lartë, i cili tregonte se sa katastrofike do të ishte për Mbretërinë e Bashkuar të prishte lidhjet me Evropën, reagimi i tij ishte: "Unë mendoj se njerëzve në

këtë vend u ka ardhur në majë të hundës me ekspertët".

Përpjekjet për të ndikuar në opinionet dhe sjelljet e një shoqërie ose të një pjese të saj janë sigurisht shumë të lashta dhe propaganda ka qenë gjithmonë një mjet i domosdoshëm në garat politike. Në ditët e sotme, megjithatë, propaganda, post-e vërteta, përhapja në shkallë e gjerë e gënjeshtrave dhe Gaslighting kanë marrë një fuqi dhe toksicitet të paparë.


Teknologjitë e reja të informacionit lejojnë individët dhe grupet të zënë skenën qendrore në mënyra që më parë ishin të disponueshme vetëm për qeveritë, partitë apo korporatat, dhe ne kemi parë tashmë manifestimet më të liga të përdorimit të mediave sociale për thellimin e ndarjeve, përhapjen e gënjeshtrave dhe nxitjen e kaosit. Prandaj është urgjente të mbrohen shoqëritë nga përdorimi jo i shëndetshëm i këtyre platformave të reja; për këtë qëllim, është prioritet vendosja e kostove dhe pasojave ndaj sulmuesve dixhitalë dhe atyre që

lehtësojnë sjelljen e tyre të papranueshme.

Është inkurajuese, për shembull, të shohësh se si gjykatat amerikane kanë vendosur gjoba miliarda dollarëshe për një personazh monstruoz si Alex Jones, i dënuar për shpifje ndaj familjeve të fëmijëve të vrarë në masakrën e shkollës fillore në Sandy Hook.

Po kështu, një proces gjyqësor i madh është duke u zhvilluar nga kompania Dominion Voting Systems kundër Fox News, e cila, sipas Dominion, për ditë të tëra gënjeu për besueshmërinë e sistemeve të saj të votimit, duke i shkaktuar dëme të mëdha.

Edhe Donald Trump ka nisur të paguajë për herë të parë kostot politike për përpjekjen e tij për të bërë lëmsh shoqërinë me gënjeshttrat e tij për mashtrime zgjedhore, të cilat e shtynë të kërkojë edhe pezullimin e Kushtetutës. Vetëm duke vendosur kosto të larta monetare, ligjore dhe reputacionale, shoqëria mund të mbrohet nga Gaslighting kolektiv. / Në shqip nga bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Kuka: Laura nuk e viziton me muaj familjen vetëm që të mos humbë asnjë stërvitje

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Sporti i xhudos vazhdon të mahisë botën dhe ta bëjë krenar shtetin e Kosovës me sukseset duke fituar medalje të arta, të argjendta e të bronzta. Sukseset e mëdha u arritën së fundi edhe në Mastersin e xhudos për vitin 2022 ku Distria Krasniqi e fitoi medaljen e artë, kurse Laura Fazliu të argjendit. Për të gjitha këto sukseset të tyre, e veçanërisht për atë të Laura Fazliut, ka shkruar trajneri Driton Kuka, i cili ka folur për përkushtimin e saj në punën për t'i arritur këto sukseset. Ai ka thënë se Laura në shumë

raste nuk e viziton për muaj të tërë familjen e saj në Mitrovicë vetëm që të arrihen këto sukseset. "Nga këndi i një trajneri. Buzëqeshja e Laurës për medaljen në Masters! Përkushtim e sakrificë që po shpaguehet ditë-ditës. Ndodh që kalojnë muaj të shumtë pa vizituar familjen e saj që jeton në Mitrovicë, vetëm e vetëm që të mos humbë asnjë stërvitje të vetme, e kjo shpaguehet. Sistemi i punës në ekipin tonë funksionon sikur detyrat e vështira të matematikës, po nuk u ndale, rezultatet vijnë, patjetër", ka shkruar Kuka.



Feyenoordi i shtohet garës për Jasharin

CYRIH, 23 DHJETOR - Askush nuk dyshon në Zvicër se Ardon Jashari do të bëhet një lojtar i madh në të ardhmen. E të njëjtin mendim e kanë edhe drejtuesit e shumë klubeve evropiane që janë vënë pas mesfushorit shqiptar me pasaportë zvicerane. Skuadra e fundit që është vënë pas talentit shqiptar është gjiganti holandez Feyenoord Rotterdam i cili e ka përcjellë nga afër Jasharin. Siç ka raportuar ekskluzivisht mediumi zviceran "4-4-2.ch", një delegacion i gjigantit holandez e ka ndjekur Jasharin në disa ndeshje në kampionatin zviceran para përfshirjes së tij në listën e të ftuarve nga Murat Yakin për Kupën e Botës. 20-vjeçari është i gatshëm për ta bërë hapin e madh në karrierë, derisa Feyenoord pritet të bëjë gjatë ditëve në vazhdim një ofertë zyrtare. Kontrata aktuale e shqiptarit me Luzernin është valide deri në verën e vitit 2026, derisa skuadra zvicerane synon të fitojë rreth shtatë milionë euro nga shitja e tij. Kujtojmë që ditë më parë mediet në Zvicër kanë raportuar se për Jasharin interesim kanë shprehur skuadra nga Anglia, Gjermania e Italia. Arsenal, Leicester City, Napoli, Hoffenheim, RB Leipzig dhe Wolfsburg janë klubet e tjera që kanë shprehur interesim për talentin shqiptar.



Agim Agushi futet në librin Guinness

Prishtinë, 23 dhjetor - Zhongleri i famshëm kosovar, Agim Agushi, të premtën u fut në librin e rekordeve Guinness pasi ai zhveshi 23 fanella nga trupi, në të njëjtën kohë zhonglonte topin në kokë. Agim Agushi e mposhti amerikanin Abraham Munaz i cili e zotëronte këtë rekord që nga viti 2019 duke i zhveshur 22

fanella. Menjëherë pamjet e këtij rekordi do të dërgohen në Londër, ku do të vërtetohet rekordi i radhës i Guinness për profesorin e Matematikës. Brenda vitit 2022 Agim Agushi synon ta thyjë edhe një tjetër rekord në Turqi, në Kullën transmetuese në Kodrën e Çamllëxhas në Stamboll.



FKV-ja fiton projekt të rëndësishëm nga FIVB

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Federata e Volejbollit e Kosovës (FKV) ka fituar një projekt shumë të rëndësishëm nga Federata Ndërkombëtare e Volejbollit

(FIVB) për përkrahjen e ndërtimit të ekipeve përfaqësuese të Kosovës. Në bazë të projektit në fjalë, FIVB siguron një trajner profesional për ndërtimin

dhe zhvillimin e ekipeve zinxhirë të Përfaqësueses së Kosovës për një vit, me mundësi vazhdimi për dy vjetët e ardhshëm. Ky është një lajm jashtëzakonisht i

mirë për volejbollin kosovar, derisa prioriteti dhe fokusi i FVK-së gjithmonë ka qenë ngritja e cilësisë, sidomos grupmoshave të reja.



'Transfermarkt': Mbappe më i vlefshëm se Haalandi

PARIS, 23 DHJETOR - Kylian Mbappe e ka rikthyer sërish pozitën e parë si futbollisti më i vlefshëm në sajtin e njohur "Transfermarkt". Shkaktohet për këtë u bë Kupa e Botës, ku Mbappe shkëlqeu. Ai ka vlerë 180

milionë euro në "Transfermarkt" tani. Erling Haaland ishte lojtari më i vlefshëm në planet nga 3 nëntori deri më 23 dhjetor. Norvegjezi zuri vendin nga Kylian Mbappe, duke i dhënë fund sundimit të

superyllit francez në krye të renditjes. Por Mbappe tani është kundërpërgjigjur, duke parë që vlera e tij në treg të rritet nga 160 milionë në 180 milionë euro pasi fitoi Këpucën e Artë në Kupën e Botës, duke e udhëhequr

ekipin e tij deri në finale, ku ai ishte lojtari i jashtëzakonshëm pavarësisht se Franca në fund u mund nga Argjentina. Ndërkohë, Erling Haaland tani është në vendin e dytë me 170 milionë euro vlerë.



Batatina: Ka kaluar koha e takimeve nëpër kafene, klubet duhet të takohen në FFK

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Duket e çuditshme, por institucioni i sportit, siç është në këtë rast MKRS, në vend që të mbledhë dhe ta stabilizojë sportin, ajo me një rekomandim të lëshuar në opinion ditët e fundit, duke i kërcënuar klubet se do t'ua ndalë ligjin për sponsorizim pasi FFK nuk është e licencuar ende, me të drejtë ka shqetësuar tejmase klubet e futbollit kosovar. Madje ky rekomandim ka nisur t'i ndaj dhe përçajë klubet ndërmjet vete dhe t'i acarojnë raportet. Disa klube që edhe më herët janë njohur si kundërshtarë të FFK-së sot janë takuar dhe po diskutojnë se cili mund të jetë hapi i ardhshëm. Në anën tjetër klubet të cilat që nga fillimi janë pozicionuar krah institucionit, në këtë rast FFK-së, po pretendojnë se faji për këtë acarim të situatës është te ministria e cila po ngjallë shqetësime te klubet.

Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, e ka komentuar takimin e sotëm të disa



klubeve derisa ka thënë se koha për takime nëpër kafene ka kaluar. Sipas tij, klubet duhet të shkojnë në FFK dhe aty të kërkojnë sqarime rreth licencimit apo jo të FFK-së në MKRS. "Për momentin gjendem në Shqipëri, por neve duhet me na ftu federata, sepse ka kaluar ajo koha kur jemi mbledhur në kafe për me diskutu. Kjo është temë e rëndësishme, dhe nëse ka ndonjë zhvillim në këtë drejtim, klubet duhet t'i thërrasë FFK-ja, sepse ai është institucioni, jo ne", ka thënë

Batatina për "RTV Dukagjinin". Ndryshe nga Batatina, takimin e ka konfirmuar presidenti i Trepçës '89, Abedin Zeka, i cili ka thënë se do të takohen për të parë se çfarë po ndodh. "Po, do të takohemi sot gjatë ditës për të diskutuar rreth këtyre zhvillimeve të fundit. Gjendja është shqetësuese, sepse nëse FFK-ja nuk licencohet do të jetë e vështirë t'i bindim njerëzit të investojnë në futboll. Një gjë e tillë nuk i konvenon fare futbollit kosovar", ka deklaruar ai.

Scaloni nuk heq dorë nga Messi: Shpresoj të qëndroj, e dua për Botërorin e vitit 2026

BUENOS AIRES, 23 DHJETOR - Lionel Messi deklaroi se ai i Katarit do të ishte Botërori i fundit për të. Në fakt, "pleshti" mund ta mbyllë me nder karrierën e tij në Kupat e Botës teksa ia ka dalë të vendosë rekorde të shumta, të shndërrohet në golashënuesin më të mirë për Argjentinën por, më e rëndësishmja, ia doli ta ngrrej lart trofeun. Megjithatë, në kombëtare shpresojnë që, pavarësisht prej moshës, Leo Messin ta kenë në skuadër edhe për Botërorin e vitit 2026. Është trajneri Lionel Scaloni së fundmi i bën një ftesë 35-vjeçarit për ta rishikuar vendimin e tij. "Të kesh në skuadër një si Messi është luks. Unë shpresoj shumë që



ai të mos ketë luajtur Botërorin e fundit. Mbetet për t'u parë nëse do të vazhdojë, por ne nuk i humbasim shpresat. Unë do t'ia mbaj një vend për në Botërorin e

radhës. Ai e ka fituar të drejtën për të zgjedhur të ardhmen. Për mua ishte një kënaqësi fakti që mund ta trajnoja Lionel Messin", u shpreh Scaloni.

SHKURT

Laporta: Rikthimi i Messit është i vështirë

Barcelonë, 23 dhjetor - Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, ka pranuar se rikthimi i Leo Messit në katalonjë mbetet një mision i vështirë. "Messi është një lojtar i PSG-së, ai fitoi Kupën e Botës dhe ne jemi shumë të lumtur për këtë sepse është një titull që e meritonte. Do të isha shumë i lumtur nëse ai do të kthehej, por nuk dua të krijoj pritshmëri për diçka. Mbetet shumë e vështirë për momentin", ka deklaruar Laporta për kanalet e klubit. Laporta më pas ka shtuar: "Nuk duam të mashtrijmë askënd. Leo është më i miri i të gjitha kohëve".

Hamiltoni për Mick Schumacher: Ka talent të madh, një fitore për Mercedesin

Lewis Hamiltoni ka folur për ardhjen e Mick Schumacher te Mercedesi, ku do ta zë pozicionin e pilotit të tretë për sezonin e ri në Formula 1. Shtatë herë kampioni i botës, për mikrofonat e "Sport Bild", u shpreh shumë i lumtur me zbarkimin e djalit të Michael, i cili në dy sezonet e fundit ka garuar për Haas. "Mick është shumë i talentuar. Është një fitore për Mercedesin. Ai është një pilot gjerman. Babai i tij Michael dhe Mercedesi ishin tashmë shumë të afërt. Sot nuk punon aq ngushtë me pilotin e tretë, është shumë punë në simulator dhe jo si më parë, edhe nëse do të vazhdojmë të jemi shokë të skuadrës", ka thënë Hamiltoni.

Ochoa nënshkruan për Salernitanan

Portieri meksikan Guillermo Ochoa ka nënshkruar me klubin e Serisë A, Salernitanan. Portieri 37-vjeçar do ta ketë përvojën e tij të parë në Serinë A. Ochoa edhe zyrtarisht i bashkohet ekipit italian në një kontratë gjashtë mujore, deri në fund të sezonit aktual. Ochoa është dalluar çdoherë me paraqitjet e tij në botërore me Meksikën, kurse klubi më i madh ku është paraqitur ka qenë në Spanjë me Malagan dhe Granadan.

Atletico e dëshiron Firminon

Atletico Madridi kërkon shërbimet e Roberto Firminos. Sipas "Fichajes", Atletico po mendon të bëjë një lëvizje për sulmuesin e Liverpoolit, Roberto Firmino, për ta zëvendësuar bashkatdhetarin Matheus Cunha, i cili është afër bashkimit me Wolves. Kontrata e Firminos me Liverpoolin përfundon në fund të sezonit dhe nuk ka asnjë aluzion se ai do të rinovojë me klubin deri më tani. Raporti thotë se ai është profili ideal për taktikat e menaxherit të Atletico Madridit, Diego Simeone. Mbetet të shihet nëse do të ndodhë lëvizja e brazilianit në "Civitas Metropolitan".

Kloppi komenton humbjen nga City: Qysh në minutat e para humbëm besimin në fushë

Skuadra e Liverpoolit është eliminuar nga Carabao Cup pasi është mposhtur nga Manchester City me rezultat 3-2. Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se ka qenë një ndeshje shumë e vështirë ku në

15 minutat e para të ndeshjes kanë hupur edhe besimin në fushë. "15 minutat e para ishin shumë të vështira, luajtëm me një formacion të cilin nuk e kishim të praktikuar. Shihej qartë që kishte ende nevojë për

përshtatje, më pas kur ishim më kompaktë patëm momente të mira. City është një super skuadër dhe në fushë nuk të falë asgjë. Por, e theksoj se fillimi ishte i vështirë, për shkak se në 15 minutat e parë

humbëm edhe besimin në fushë", ka thënë Klopp. "Më pas pësuam menjëherë në pjesën e dytë, por ajo që dua të them është se pësuam gola të kotë. Në golin e tretë ne thjesht po shihnim topin derisa të

mbërrinte tek Ake që shënoi më pas, aty nuk ishte askush për të mbuluar edhe pse dy lojtarë të Cityt ishin të vetëm. Por, tashmë është një rezultat që duhet ta pranojmë", ka deklaruar trajneri gjerman.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 9.2 dhe 15 të Ligjit 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenet 5, 6, 7 dhe 13 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021), nenit 7 të Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në ZKA; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit Nr. 1666 të datës 24.08.2022, Zyra Kombëtare e Auditimit, ri shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të punës

Pozita: Drejtor i Përgjithshëm
Numri i referencës: DP/ZKA/27-12/22
Grada: ZKA-C1
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me mandat Pesë (5) vjet

Qëllimi i Pozitës:

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve të shërbimeve të përgjithshme administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për mbështetjen administrative dhe menaxhimin e administratës së përgjithshme të Zyrës kombëtare të auditimit, duke përfshirë edhe çështjet financiare, logjistike, teknologjisë informative dhe prokurimit.
- Bën përgatitjen e planeve të punës sipas Planit vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tij me qëllim të përmbushjes së mandatit dhe funksionit të Zyrës kombëtare të auditimit.
- Në bashkëpunim me njësitë tjera organizative, duke analizuar dhe vlerësuar proceset e punës brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe në pajtim me Auditorin e Përgjithshëm, vendos për ndryshimet dhe përmirësimet me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë.
- Me autorizim të Auditorit të Përgjithshëm, përfaqëson Zyrën Kombëtare të Auditimit, në fushat dhe çështjet që ndërlidhen me mandatin dhe funksionin e tij.
- Ofron udhëzime dhe këshilla të sakta dhe të paanshme profesionale për Auditorin e Përgjithshëm, në fushat përkatëse.
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë fakulteti në ekonomi, drejtësi ose administratë publike;
- Shtatë (7) vite përvojë pune në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike, drejtësisë ose administratës publike;
- Katër (4) vite përvojë pune menaxheriale.

Shkathësitë e kërkuara:

- Shkathësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Shkathësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- Dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- Dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet).

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **08.01.2023 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen/shkarkohen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00. Formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishe mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 9.2 i 15 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, i članova 5, 6, 7 i 13 Pravilnika (NKR) 03/2021 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu 16.09.2021), član 7 Uredbe (NKR) Br. 02/2021 o Klasifikaciji radnih Mesta u NKR; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu (izmenjen/dopunjen), i Odluke Br. 1666 datuma 24.08.2022 godine, Nacionalna Kancelarija Revizije, ponovo objavljuje:

KONKURS za dopunu radnog mesta

Pozicija: Generalni Direktor
Broj reference: DP/ZKA/27-12/22
Rang: ZKA-C1
Broj pozicija: Jedan (1)
Trajanje imenovanja: Sa mandatom Pet (5) godina

Svrha pozicije:

Generalni direktor je odgovoran za funkcionisanje i koordinaciju rada opštih administrativnih usluga u skladu sa važećim zakonodavstvom i aktima Nacionalne kancelarije za reviziju.

Dužnosti i Odgovornosti:

- Odgovornost za administrativnu podršku i upravljanje opštom administracijom Nacionalne kancelarije za reviziju, uključujući pitanja finansija, logistike, informacione tehnologije i nabavke.
- Priprema planove rada u skladu sa godišnjim planom Nacionalne kancelarije za reviziju, i nadzire njegovo sprovođenje u cilju ispunjavanja mandata i funkcije Nacionalne kancelarije za reviziju;
- U saradnji sa drugim organizacionim jedinicama, analizirajući i procenjujući procese rada u okviru Nacionalne kancelarije za reviziju, iu dogovoru sa glavnim revizorom, odlučuje o izmenama i poboljšanjima u cilju povećanja efikasnosti i efektivnosti u radu.
- Po ovlašćenju glavnog revizora, predstavlja Nacionalnu kancelariju za reviziju, u oblastima i pitanjima koja se odnose na njen mandat i funkciju.
- Pruža tačne i nepristrasne profesionalne smernice i savete generalnom revizoru u relevantnim oblastima.
- Na zahtev glavnog revizora, obavlja i druge poslove u vezi sa objektivima NKR-a.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma u ekonomiji, pravosuđu ili javnoj upravi;
- Sedam (7) godina iskustva u oblasti računovodstva, revizije, javnih finansija, pravosuđa ili javne uprave; i
- Četiri (4) godine rukovodećeg iskustva

Potrebne veštine:

- Visok nivo veština u upravljanju, organiziranju i postavljanju objektivna;
- Odlično znanje za efikasno nadzor nad profesionalnim radom;
- Visok nivo veština komunikacije i pregovaranja;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Veštine rukovođenja, motivacije i komunikacije u upravljanju učinkom;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate za objavljeni poziciju se vrši u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura Prijave:

Procedura prijave je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa..

Kandidati treba da dostave sledeće potrebne dokumentacije:

- Službeni Formular NKR-a za prijavu;
- Kopiju lične karte Republike Kosovo;
- Dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- Dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđen;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva).

Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu. Samo službeni formular za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije je **08.01.2023.godine do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Diviziji za administriranje dokumenatima Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u razmatranju.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "SIMIT" - Sh.P.K, me pronar Muamer Çerkezi ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811899882 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SIMIT" - d.o.o., sa vlasnikom Muamer Çerkezi donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811899882 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "SIMIT" - L.L.C, with owner Muamer Çerkezi has taken the decision to quit its business with NUI: 811899882, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Wildlife" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811446998.j.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Sot më 24.12. 2022 behën 18 vjet pa më të dashurin tonë



Liridon (Sejdi) Dërmaku

(17.07.1983 - 24.12.2004)

Bir, vëlla e axhë kaluan 18 vjet që kur të vrau armiku, i cili ishte dhe është kundër bashkimit kombëtar. Ti pusho i qet në dheun e Shqiptarisë, sepse Shqipëria po bëhet e do të bëhet ashtu siç ti dhe luftëtarët e lirisë e latë amanet. Në çdo përvjetor tëndin na pyesin, nëse po mërzitemi e po kemi mall për ty. Është e pamposhtur dhembja dhe i padurueshëm malli për ty, por krenaria që dhe jetën për jetët e shqiptarëve dhe Shqiptarisë na jep forcë që të vazhdojmë përpara. Ti je atje ku gjenden më të mirët e kombit, duke i bërë roje atdheut. Nderime Atdheut dhe lavdi ty dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë dhe bashkimin e shqiptarëve. Gjithmonë krenarë me ty!

Të kujtojnë dhe kurrë s'të harrojnë: Babai Sejdiu dhe e tërë familja Dërmaku nga Shipashnica e Epërme e Dardanës dhe Prishtina.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

